

Procesverbal

Nga mbledhja e VIII- (tetë) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë:15.09.2023

Rend Dite

- 1) Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
- 2) Propozim Vendim për shpallje të interesit të përgjithshëm publik në fshatin Restelicë,
- 3) Propozim Vendim për anulimin e Vendimit 01 Nr.941/01-11832/23 i datës 26.05.2023,
- 4) Propozim Vendim për anulimin e Vendimit 01 Nr.941/01-11833/23 i datës 26.05.2023,
- 5) Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme (objekti i destinuar për Postë në fshatin Brodosanë),
- 6) Propozim Vendim për iniciimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së),
- 7) Propozim Vendim për iniciimin e procedurave për hartimin e Hartës Zonalë të Komunës (HZK-së),
- 8) Miratimi i buxhetit 2024,
- 9) Eventuale.

Uran Halimi: Të nderum kolegë delegatë, mirë se keni ardhë në Mbledhjen VIII të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Dragashit! Nëse do me e marrë fjalën dikush në lidhje me rendin e ditës? Fjalën e ka kërkuë Driton Ademi nga PDK.

Driton Ademi: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë! Kryesues, në mbledhjen e qershorit në mos gabofsha, e kemi pas që në gusht me ardhë raportimi për buxhetin, që kemi pas problem për pagat. Në gusht nuk kemi mbajtur na seancë, atëherë u dashtë me ardhë, se ju keni thënë që brenda tre muajve kjo punë ka me u zgjidhë. Në seancën e sotme nuk ka ardhë. Brenda tre muajve, ju si Komision që jeni konë nuk e keni pru si pikë të rendit të ditës. Nuk e di ku është problemi, pse nuk e keni pru deri më sot? A duhet me e diskutue si pikë të rendit të ditës, doni me e qit, apo në pikë eventuale? Në rend të ditës edhe kjo ka qenë, që me ardhë në seancën e gushtit ka pas, brenda tre muajve.

Urani Halimi: Nuk është e vërtetë. Seancën e ke publike, mundish me hi me e gjet ku kam thënë në seancën e gushtit.

Driton Ademi: Unë po të them që ke thënë brenda tre muajve Komisioni duhet me raportue.

Uran Halimi: Okej, s'janë tre muaj, e bëjmë kismet. Faleminderit, z.Ademi! Kush do me e marrë fjalën në lidhje me rendin e ditës? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro këtij rendi të ditës? Kundër? Abstenim? Atëherë i kemi 18 vota pro, zero kundër edhe zero abstenim. Po kalojmë te pika e parë e rendit të ditës, është miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Nëse ka dikush

ndonjë vërejtje në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar, mundeni me e marrë fjalën. Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro miratimit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Kundër? Abstenim? I kemi 18 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim. Po vazhdojmë me pikën e dytë: Propozim Vendimi për shpallje të interesit të përgjithshëm publik në fshatin Restelicë. Ftoj kryetarin që të na japë një sqarim në lidhje me këtë pikë. Dje në Komitet na ka dhënë njëfarë sqarimi dhe Komiteti e ka kaluar. Nëse keni nevojë për diçka shtesë? Kryetar, nëse ka dikush me pyet, mundesh me i dhënë përgjigje. Fjalën e ka kërkuar z.Munir Jonuzi.

Munir Jonuzi: Përshëndetje të gjithëve, në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, e mirëpres një vendim të tillë. Banorët e fshatit Restelicë prej kohësh po përballen me problemin e deponimit të mbeturinave. Pas kësaj ata u organizuan sepse nuk mundën të lidhnin kontratë me Ecoregion. Ata krijuan organizatën e tyre Eko Restelica. Ata blenë kamionë dhe kështu zgjidhën përkohësisht problemin e deponimit të mbeturinave komunale. Tani më vjen mirë që komuna i plotëson dhe ndan një parcelë që shërben si pikë grumbullimi për depozitimin e mbetjeve komunale. Zoti Kryetar, gjithmonë do ta keni mbështetjen time kur bëhet fjalë për vendime të tilla dhe kur prona që më parë ka qenë në pronësi të kompanive të ndryshme do t'u kalohet qytetarëve të kësaj komune, sepse qytetarët e kësaj komune do të përfitojnë. Ju lutem gjeni një mënyrë për të trajtuar raste të tilla. E di që ju e keni tejkaluar seriozisht këtë problem. E di që ju keni krijuar një komision që do t'i regjistrojë të gjitha pronat e tilla, do t'i gjejë dhe do të përpiqet t'i kalojë në pronësi të qytetarëve tanë apo kësaj komune në bashkëpunim me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ka mundësi ligjore për t'u marrë me të. Vetëm për të shmangur situatat kur vendimet tona kthehen nga ministria. Komisioni le t'i përgatisë seriozisht dhe t'i trajtojë me seriozitet raste të tilla.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Jonuzi! Sa për informacion të qytetarëve, është fjala për Propozim Vendimin për shpallje të interesit publik me qëllim të përcaktimit të lokacionit për ndërtimin e pikës grumbulluese të mbeturinave komunale, në sipërfaqe prej 293 metër katrorë, për nevojat e qytetarëve të fshatit Restelicë. Ka të bëjë me shpalljen interes publik të një zone aty në hyrje të Restelicës, ku kryetari ka vendos që aty me e ndërtue një pikë grumbulluese për mbeturinat e fshatit Restelicë. Njësia Kadastrale, po thotë, është interes publik, e cila është pronë shoqërore e Pylltarisë së Dragashit. Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës? Kundër? Abstenim? Konstatoj që me 20 vota pro, me zero kundër dhe zero abstenim, kalon ky Propozim Vendim. Vazhdojmë me pikën e tretë me radhë: Propozim Vendim për anulimin e Vendimit 01 Nr.941/01-11832/23 i datës 26.05.2023, që ka të bëjë me deponinë. Është fjala për propozimin e mëhershëm që e ka bo, nëse s'gaboj, drejtori i Ekonomisë dhe Financave, ku

ka propozue që me u shpallë interes i përgjithshëm publik dy parcela që është paraparë me u ndërtu deponi e mbeturinave të ngurta në fshatin Rrenc, a po? Domethënë, ky Vendim është kthyer prapë nga MAPL edhe duhet ta shfuqizojmë. Kryetari po e kërkon fjalën, pas tij keni të drejtë edhe ju me bo pyetje.

Bexhet Xheladini: I nderuar kryesues, zv/kryesues, të nderuar delegatë! Ju përshëndes, ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje në këtë seancë! Sa i përket Propozim Vendimit të cilin e lexoi kryesuesi, unë dua të them se MAPL na ka kthyer mbrapsht këtë Vendim dhe ka thënë që me e rishqyrtue. Nuk është i kundërligjshëm, por me e rishqyrtue, dhe ka thënë për pronat të cilat janë ish-prona shoqërore, sipas Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, janë prona nën administrimin dhe menaxhimin e AKP-së, dhe si të tilla, Qeveria ka të drejtën ekskluzive të bëjë shpronësimin e tyre, konform nenit 43 të këtij Ligji. Gjithashtu, edhe për Vendimin e dytë – se pas këtij vjen edhe Vendimi tjetër. Ndërsa, sa u përket pronave shoqërore të ekonomisë pyjore, Departamenti i Shpronësimit rekomandon që t’i drejtohem Ministrisë së Bujqësisë, sepse këto prona janë nën menaxhimin e Agjencisë së Pyjeve të Kosovës, e cila është në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Ju siç e dini, Asambleja ka votue për dy prona të cilat janë pronë e Pylltarisë, për ndërtimin e dy deponive të mbetjeve inerte. Ne këto dy vendime i kemi çue në Ministrinë e Bujqësisë. MB nuk na ka kthye kurrfarë përgjigje. Atëherë unë kam qenë në takim dhe jam marrë vesh që ne këto kërkesa t’ia drejtojmë Qeverisë. Ia i kemi drejtue Qeverisë dhe ajo na i ka aprovue dhe na këto prona i kemi marrë me Vendim të Qeverisë. Këto prona tash janë të Komunës dhe me këto ne mund të bëjmë ndërtimin e këtyre dy deponive të ngurta. Kështu që, ne në këtë drejtim jemi fitues, për arsye se po të na kishte dhënë pëlqimin Ministria e Bujqësisë, ne do të ishim të detyruar të paguanim edhe taksë. Tani, me vendimin e Qeverisë ne nuk kemi nevojë të paguajmë edhe taksë edhe ne mund të fillojmë me ndërtimin e këtyre deponive. Andaj, u propozoj delegatëve që të bëjnë anulimin e këtij Vendim dhe, pasi që pronat i kemi marrë, me qëllim që mos të vjen puna deri te ndonjë padi eventuale nga ana e MAPL-së. Gjithashtu, për mos me dalë unë edhe një herë, e bëra edhe arsyetimin e Vendimit tjetër, ku është fjala për Pompën e benzinës, që edhe këtu e kemi shpallë si interes të përgjithshëm. Mirëpo, arsyetimi i MAPL-së është se shpronësimin ka të drejtë me e bo vetëm Qeveria, prandaj edhe ky Vendim duhet të anulohet. Por ne nuk i kemi drejtue vetëm Qeverisë me këtë, por i kemi drejtue edhe AKP-së. Nga AKP-ja ende nuk kemi marrë përgjigje, mirëpo përgjigje indirekte kemi se AKP ia ka dhënë në shfrytëzim një kompanie tjetër Pompën të cilën ne e kemi shpallë interes publik. Andaj, propozoj edhe për këtë pikë që të bëhet anulimi i saj. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Dikush tjetër? Nedžmidin Sejdilar e ka kërku fjalën.

Nedžmidin Sejdlar: Pershendetje te gjithëve propozimi për heqjen e vendimit nga seanca e kaluar dhe në komision kërkoja përgjigje në lidhje me pompën meqë fole kam një pyetje dhe po kërkoj përgjigje. Atë pronë e kemi shpallur interes publik që është në favor të komunës së Dragashit dhe jam dakord me këtë, madje e kam mbështetur dhe votuar iniciativën që ajo pikë karburanti të shpallet interes publik. Sepse do të përfitojnë më shumë qytetarët e komunës sesa një privat që do të shesë derivate.

Uran Halimi: Më fal që po interferoj! Jemi duke folë për pikën e katërt, edhe pse kryetari e dha paraprakisht përgjigjen. Mundësisht qet pyetje bëje tash, që me t'u përgjigj në pikën e ardhshme...në jemi t'u folë për pikën e tretë. Kur të vjen pika e katërt, folish për pikën e katërt. Për pikën e tretë nëse ka dikush me pyet, ju lutem!

Shpetim Hajredini: Përshëndetje, kryetar! Përshëndetje të nderuar drejtorë, kolegë asambleistë, të nderuar qytetarë të Dragashit! Ne jemi prononcuar gjithmonë se jemi këtu për të mirën e qytetarëve, mirëpo, gjithashtu, shumë herë kam dalë dhe kam thënë që nuk është mirë që të ngutemi dhe të marrim vendime, pa u konsultuar me njerëz kompetentë të cilët e dinë ligjin, i dinë rregulloret, por këtu po vazhdohet me të njëjtin avaz. Po marrim vendime, muajin tjetër po na kthehen mbrapsht nga MAPL-ja, do të marrim prapë vendime tash. Kështu që, nuk është në rregull sepse do të dalim keq para Ministrisë në si Komunë. Dalim si komunë që nuk kemi njohuri bazike ligjore. Është mirë që në të ardhmen, kur të merret një vendim, së pari të konsultohen njerëz kompetentë ligjorë, të cilët kanë njohuri edhe të marrin vendim, ne do ta votojmë sa herë që të jetë për të mirën e qytetarëve. Këtu jemi për qytetarët dhe sa të jemi në këtë pozitë gjithmonë do t'i mbështesim ato vendime të cilat janë në të mirën e qytetarëve. Por jo në këtë formë, sa që gjithmonë të na kthehen mbrapsht, marrim vendime dhe na kthehen mbrapsht, ne kemi arsye, normalisht. Kjo nuk është në rregull sa më përket mua, por besoj edhe për të gjithë ju, asambleistë, nuk do të jetë në rregull një gjë e tillë. Andaj, kërkoj nga ju, ekzekutiv, që të jeni të kujdesshëm që në vendimet e ardhshme të koordinoheni mirë dhe të na vijnë vendime të cilat bazohen në ligj dhe në rregullore të cilat janë nxjerrë nga ministritë përkatëse. Ju falemnderit!

Uran Halimi: Falemnderit, z.Hajredini! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Fjalën e ka kërkuar z.Edin Kurt.

Edin Kurt: Pershendetje te gjithëve, besoj se nuk jemi kuptuar mire, nuk e di si eshte ne materialin tuaj, por per mua pika e trete e rendit te dites eshte anulimi i vendimit 9411/1832, ky eshte Vendimi. që e kishte fjalën zoti Sejdlar, për pompën. Në rastin tonë, pika numër 3 është për pompën dhe jo për landfillin e mbetjeve të ngurta. Tani nuk e di se cilin pikë po votojmë, ju zëvendësuat zotin

Sejdilar që foli për pikën e rendit të ditës në pompë, kështu është me ne, nuk e di si është në materialin tuaj dhe unë. nuk e di se për cilën pikë të rendit të ditës po diskutojmë.

Uran Halimi: Faleminderit për korigjimin, i nderum delegat! I bjer që edhe Nedžmidin Sejdilar ka pas të drejtë kur ka folë për Pompën. Domethënë, Vendimi me numër 11832 i përket Pompës së benzinës që është përballë Stacionit të Autobusëve në Dragash. Atëherë është gabim, tash mundesh me folë, Nedžmidin. Është fjala për Pompën, është gabim teknik, kërkoj ndjesë për këtë! Edhe një herë të ju sqaroj, te pika e tretë është fjala për parcelën e Pompës përballë Stacionit të Autobusëve, ndërsa te pika e katërt kemi të bëjmë me parcelat të cilat i kemi shpallë si pronë të Komunës për interes të përgjithshëm publik, me lokacion në fshatin Rrenc. Vazhdo, Sejdilar!

Nedžmidin Sejdilar: Herën e kaluar e kemi deklaruar atë pronë me interes publik dhe realisht dhe përgjithësisht logjikisht do të ishte më e dobishme që ajo parcelë të jetë në pronësi të komunës së Dragashit sesa të një individi privat. Ajo parcelë është në hyrje të komunës sonë dhe ne mund të ndërtonim diçka të bukur në atë vend apo atë lokacion që do të pasqyronte pasqyrën e komunës sonë. Mua më intereson arsyeja konkrete se përse na është kthyer ai vendim nga Ministria e Pushtetit Lokal, kur nga praktika e dimë se kemi deklaruar shumë lokacione të tjera në komunën tonë në interes publik nga AKP-ja dhe kemi arritur të kthehem. ato vende në pronësi tonë. Cili është problemi me pompën? Dhe çfarë do të ndodhë tani nëse ky kuvend nuk e anulon atë vendim nëse do të mbetet në pronësinë tonë, në mënyrë që të jetë në interes të qytetarëve tanë. Nëse, për shembull, sot konfirmojmë vendimin tonë se kemi votuar më herët si delegatë të zgjedhur ligjërisht të popullit. Nëse ky kuvend nuk e kthen atë vendim, me çfarë do të përballemi ne, ky kuvend.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Sejdilar! Ju besoj që e dini, MAPL është mbikëqyrësi i seancave edhe korigjues, në këtë rast. Kur ta marrim na një vendim, i bjer që na s’kemi të drejtë me marrë vendime që janë kundër ligjit. Edhe pse jemi të zgjedhur të popullit, ne s’mundim me punu kundër ligjeve të shtetit të Kosovës. Çdo sugjerim, çdo vendim që na – besoj që pa dashje – e marrim si të paligjshëm ose votojmë një vendim që shpallet i paligjshëm, na e kemi për detyrë me i ndjek ligjet e Kosovës. Përgjegjësinë e mbajmë ne si Kuvend, e jo kryetari në këtë rast. Kështu që, na duhet patjetër me e shfuqizue. Kryetari po e kërkon fjalën, po do me na dhënë pak sqarim.

Bexhet Xheladini: Nedžmidini ka të drejtë. Edhe unë në fillim thashë që Ministria ka kërkue me e rishqyrtue. Ne kemi të drejtë me shpallë interes të përgjithshëm, se e kemi shpallë, pronat e AKP-së që janë, kemi shpallë interes të përgjithshëm edhe i kemi marrë pastaj në menaxhim. Kështu që, është e drejtë e juaja ekskluzive që mos me e aprovue, me e lënë në fuqi. Edhe unë jam për këtë formë, por AKP i a ka dhënë në shfrytëzim për disa vjet dikujt prapë atë. Por kjo nuk do të thotë që na do të

heqim dorë prej saj. Ne nuk do të heqim dorë deri ta marrim, se ajo po na duhet neve. Kështu që, pasi Ministria ka thënë me e rishqyrtue, ju mundeni me e lënë në fuqi këtë Vendim. Unë mendoj se nuk është e kundërligjshme që ne e kemi prurë atë Vendim. Është çështje e juaja, unë nuk dua të ndërhyj, po këtu është problemi. Ju vendosni, ju e keni të drejtën, se edhe mu m'u ka dukur jo e arsyeshme, pse me e kthye këtë. Ne kemi prurë vendime të tilla edhe nuk na janë kthyer si të paligjshëm. Unë e lexova sqarimin, po na megjithatë, kërkesën unë vetë personalisht, me Qamilin kemi qenë në AKP, e kemi dorëzuar, e kemi protokoluar dhe kërkesa ende është në AKP, neve nuk na është kthyer ende përgjigjja. Është e drejtë e juaja me e lënë në fuqi, nuk është problem, mu ma shumë më konvenon. Ne megjithatë, edhe pse ata e kanë kthye, ne nuk do të ndalemi, ne duam me e marrë në pronësi të Komunës, se është në interes të Komunës, është në hyrje të qytetit, e ka ngulfat qytetin, aty duhet të ndërtohet diçka që na përshtatet neve. Prandaj ju analizojeni, mundeni me dalë prapë me diskutue. Para se me ardhë në seancë, unë e pata edhe përfaqësuesin ligjor të Komunës, një konsultim për këtë pikë, edhe Ademi nuk kishte përgjigje të saktë se çka me bo. Por e drejta e juaj është me vendos ju. Ju delegatët nuk keni përgjegjësi nëse votoni.

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Kjo është përgjegjësi edhe e kryesuesit, edhe e jona në përgjithësi si Kuvend, edhe e kryetarit gjithashtu. Na duhet patjetër me e rishqyrtue këtë, meqenëse na është obligue për me e rishqyrtue. Përndryshe, ne kemi mund mos me e qitë hiç në rend të ditës edhe kish mbetur në fuqi Vendimi që e kemi marrë ma herët. Kështu që, na duhet patjetër me e rishqyrtue, se është përgjegjësi ligjore edhe e jona si Kuvend, edhe e ekzekutivit në këtë rast. Mundeni me e marrë fjalën. Nedžmidini e ka kërkuar, një minutë e ke Nedžmidin, edhe pas tij fjalën e ka Driton Ademi. Pas Dritonit, Munir Jonuzi.

Nedžmidin Sejdirar: Vetëm për të bërë të qartë një gjë, mes meje dhe jush si shef ekzekutiv. Të gjithë ne këtu në këtë sallë pajtohemi se është me interes të madh publik për komunën e Dragasit. Nuk kemi dilema, as unë si delegat dhe as ju si kryetar i qeverisë ekzekutive. Nëse ne tani, në këtë kuvend, konfirmojmë të njëjtin vendim që ende mundohemi ta mbajmë në pronësi dhe ta shpallim interes publik, ju nuk keni problem me këtë, ju si parti, ju si kryetar i komunës. Nëse ky kuvend, me sugjerimin tim apo të dikujt tjetër, tenton ta mbajë atë parcelë në pronësi të komunës së Dragashit, nuk do të ketë problem as qeveria e as opozita, a është kështu, dhe vendimin do ta çojmë në ministri të administratës vendore. Nga praktika kur më parë na kthenin vendime, si vendimin e Këshillit të Sigurimit, ne konfirmuam të njëjtin vendim dhe tani ai vendim është në fuqi, pse të mos bëjmë të njëjtën punë me këtë pompë, pavarësisht se dikush e ka marrë parcelën me qira për një ose dy vjet. Ai afat do të skadojë dhe më pas ne do ta mbajmë atë komplot në posedim tonë. Unë jam që vendimi

ynë i mëparshëm të konfirmohet dhe të mos heqim dorë nga ajo komplot dhe ta shpallim atë si interes publik.

Driton Ademi: Faleminderit, kryesues! Unë po propozoj që, masi nuk e kemi për ngut edhe nuk ka pru vendim AKP-ja, nuk ka marrë vendim për këtë parcelë, me e lënë në seancën e ardhshme, ose në seancat tjera, derisa ta bjer një vendim AKP-ja, tani na me marrë një vendim ose për anulim ose për rishqyrtim të mëtutjeshëm. Unë po mendoj kështu, me e lënë ni herë, sot mos me e anulue, deri me ni vendim të ardhshëm. Nuk e kemi për ngut na, për sot patjetër me e anulue këtë Vendimin. Mundim me e shty edhe në seancën e ardhshme, nëse nuk e kemi ligjore për me shqyrtue sot.

Uran Halimi: Unë po due me ju dëgjue krejtve edhe në fund jau u jap një përgjigje. Faleminderit për propozimin, Driton! Po s'mundim na pronën e huaj me e tjetërsue, se na marrim padi prej AKP-së. A po doni me e qit në gjyq AKP-ja Komunën a, ose Kuvendin Komunal. Nëse është pronë e huaj ajo, nëse është pronë e AKP-së edhe na nuk e shfuqizojmë Vendimin, i bjer që qëllimisht jemi t'u dashtë me e qit veten në gjyq. Pronën e huaj na jemi duke e tjetërsue. Çohet AKP-ja edhe ankohet, thotë që ju s'mundeni me pronën teme me shpallë interes publik. Ju e dini shumë mirë në qeverisjet e mëhershme, kur është prek prona e AKP-së, çka e ka gjet Komunën edhe çka po vazhdon me e gjet Komunën për vendimet e pronave të AKP-së. Nëse ju mendoni me e lënë në fuqi – unë e hoqa barrën teme që më përket si kryesues i Kuvendit – përndryshe s'mundim me e lënë në fuqi, na duhet me e rishqyrtue sot. Na mundim me rivendos në të ardhmen, kurdo që i skadon atij kontrata, se ai e ka marrë qetash, ka pague me siguri koncesion a qira apo çka ka pague, s'munden AKP-ja me i kthye atij kompensim për një Vendim të Kuvendit Komunal të Dragashit, pse na po mendojmë ashtu. Po ia kthen Komuna atë, nuk ia kthen AKP-ja. Është pronë e AKP-së, nuk është pronë e Komunës ajo. Neve na intereson me e rishqyrtue këtë Vendim. Pjesën tjetër ligjore s'është rrezik, neve e kemi patjetër me e shfuqizue këtë Vendimin. Fjalën e ka Munir Jonuzi dhe pas tij Samidin Xheladini.

Munir Jonuzi: Pershendetje te gjithëve. Është me interes parësor për të gjithë ne këtu në këtë sallë që të mbrojmë të drejtat e qytetarëve dhe që sa më shumë parcela të bëhen pronë e komunës. Megjithatë, në Kosovë, ndarja e pronës ekziston në disa mënyra. Ka pronë private, ka pronë komunale, pronë shtetërore dhe pronë të huaj. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme, pse e përmend. Sepse kjo pompë është në pronësi të industrisë së naftës INA, është kompani kroate, mund të ndodhë nesër, kur të ulen në tavolinë dhe kur të diskutojnë për kthimin e pronës së palës kosovare dhe kroate, atëherë mund të jemi përgjegjës. pse kjo parcelë është shpallur në pronësi të komunës. INA është një kompani private dhe prona e tyre private është e drejtë e patjetërsueshme e çdo personi, pavarësisht nëse janë shtetasit tanë apo jo. Që nesër të mos kemi probleme gjyqësore, sidomos

presidenti dhe kryetari e ndoshta edhe unë, sugjeroj që gjithsesi ta anulojmë këtë vendim, sepse nuk mendoj se mund ta kalojmë në emër të komunës së Dragasit. Do të doja, si të gjithë të pranishmit këtu, por nuk mendoj se mund ta bëjmë këtë.

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm, ju përsëndes të gjithëve! Po duhet me e shpreh atë që duhet me e thënë edhe duhet me vendos na në këtë formë. Na jemi pushtet lokal, Qeveria i ka punët e veta, ministritë i kanë punët e veta, ne i kemi punët tona. Ne jemi organi më i lartë i Komunës. Ky është interes i qytetarëve të Komunës sonë. Se qysh e kanë marrë, ato janë çështje që duhet t'i zgjidhin ata që i kanë marrë, ose gjyqet. Na, në qoftë se e anulojmë Vendimin, heqim dorë prej pronës, po pajtohna që nuk është pronë e jona. Kjo është pronë e jona edhe na duhet Vendimin me e votue që me mbet në fuqi. Në qoftë se e shohim na, për shembull, që duhet me marrë edhe ndonjë vendim tjetër konform interesave tona, prapë e marrim. Unë jam i mendimit që me e hedhë në votim edhe me mbet në fuqi Vendimi që e kemi marrë na vetë. Po më vjen keq, po ma vonë e kuptoni pse.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Xheladini! Një minutë e ka kërkue z.Shpetim Hajredini.

Shpetim Hajredini: Atëherë përsëndetje edhe një herë për të gjithë! Këtu ose ka disa prej nesh këtu që nuk dojnë me e kuptue, ose realisht nuk po e kuptojnë. Të nderuar kolegë, e kemi një Vendim i cili na ka ardhur nga kryetari për anulim. Është nga kryetari. Mirëpo arsyen e ka dhënë shumë të qartë: vendimi i kthimit të këtij Vendimi të mëhershëm është i MAPL-it. Se po thotë: Për shkak të pamundësisë të plotësimi të kërkesave ligjore të kërkuara nga ana e MAPL-së, pasi që pronat e lartcekura janë prona shoqërore të cilat, sipas Ligjit për shpronësim, do të thotë i takojnë për momentin, qekjo pronë për të cilën po diskutojmë, i takon AKP-së. Na kemi dashtë me e kthye, mirëpo Ministria ne e ka kthye që jo, nuk bën se është pronë e AKP-së. I nderuar, AKP-ja është institucion, ti e dish shumë mirë, që nuk lëshon pe. Edhe pronën e vet ti nuk ke të drejtë me ia marrë atij. Okej, ti mujsh me provue me ia marrë, po unë të garantoj që qeto organe, ekzekutivi ynë ka me u përballë në gjyqësi, në prokurori, edhe s'un e merr. Atë ta garantoj, AKP-së nuk ka ndodhë me ia marrë pronën hala askush. Le t'ia marrin, unë jam për me anulue dhe për me rikthye prapë në një moment tjetër, në një seancë tjetër, kur marrin edhe përgjigje nga AKP-ja ekzekutivi. Në momentin që merr ekzekutivi përgjigje nga AKP-ja, se ka të drejtë, atëherë na pas një viti, ose pas gjashtë muajve, kurdo që të jetë e nevojshme ne votojmë, pasi që është në të mirën e qytetarëve. Ky është mendimi im, tash le të vendosin shumica.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Hajredini! Faleminderit që e lexove këtë që edhe unë pata me e lexue. Vazhdimi i asaj të cilën ju e lexuat thotë që: Janë prona të paluajtshme nën administrimin dhe menaxhimin e AKP-së dhe, si të tilla, vetëm Qeveria ka të drejtën ekskluzive të bëjë shpronësimin e

këtyre pronave. I bjer që shpronësimin e qetyne pronave të AKP-së vetëm Qeveria ka të drejtë me e bo. Ju lutem, i kemi dhjetë minuta pauzë, konsultohuni grupet parlamentare në mes vete. Dhjetë minuta pauzë edhe kthehemi në seancë.

Të nderum delegatë, ju lutem që t'i zëni vendet e juaja! Po vazhdojmë aty ku e lamë. Kemi kuorum edhe mundim me procedue me pikat tjera. Po vazhdojmë me pikën e tretë, tash ekzekutivi ma servoi edhe një kontratë që e ka nënshkru INA, kompania pronare e Pompës në këtë rast, që është lidhë kontrata me Delta Group. I bjen që kjo kontratë është nënshkruar më 16 qershor, ndërsa ne Vendimin e kemi marrë më 26 maj. Diku dhjetë ditë masi na e kemi marrë Vendimin, këta veç e kanë nënshkruar kontratën. Numrin e protokollit e kam më 16 qershor të kontratës, ndërsa në këtë rast e kemi marrë Vendimin më 26 maj. Dhjetë ditë masi na e kemi marrë Vendimi, këta e kanë nënshkruar një kontratë dhe është dhënë me qira. Për atë është shumë e udhës që na, edhe mas kërkesës së MAPL-së, është shumë e udhës që na me e shfuqizue këtë Vendim edhe me prit kohën kur i skadon afati këtyre kontratave, besoj që kemi ndonjë mundësi ma të favorshme me e rikthye Vendimin e datës 26.05.2023. Po e qesim në votim, meqenëse diskutuam në lidhje me këtë pronë. Kush është pro vendimit për shfuqizimin e këtij Vendimi? Kush është kundër? Abstenim? I kemi 12 vota pro, 1 kundër dhe 5 abstenime, shfuqizohet Vendimi. Vazhdojmë me pikën e katërt: Propozim Vendimi për anulimin e Vendimit 11833/23 të datës 26.05.2023. Diskutuam edhe për këto parcela në fshatin Rrenc. Nëse është shterrë debati, unë po mendoj që është mirë me e hedhë në votim. Nëse do me e marrë dikush fjalën eventualisht? Okej, po e hedhim në votim. Kush është pro anulimit të këtij Vendimi? Kundër? Abstenim? Kemi 17 vota pro, zero kundër edhe 2 abstenim, kalon edhe pika e katërt e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e pestë: E kemi Propozim Vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme. Është fjala për objektin e destinuar për postë në fshatin Bresanë. Nëse do dikush me e marrë fjalën, ju e keni lexue po besoj materialin. Kryetari po do me na dhënë një sqarim.

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, e keni lexue Propozim Vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale - është fjala vetëm për objektin – për shfrytëzim të përkohshëm, pa të drejtë të privatizimit. Vetëm duhet ta bëjmë një përmirësim, ku në vend të kompenzimit prej 10 euro, duhet 12 euro, do të thotë 1 euro në muaj. Është një vendim i njëjtë sikurse i është dhënë prona KESCO-s për ndërtimin e Trafostacionit në Mejdanin e Shajnes. Siç e dini, këtë objekt e ka ndërtue fshati me vetëkontribut dhe para luftës ai objekt është shfrytëzuar si shkollë e mjekësisë. Tani një pjesë e këtij objekti është duke u shfrytëzuar nga Vala, kurse për pjesën tjetër të objektit ne mendojmë që t'ia japim Postës ta shfrytëzojë dhe Posta, nga objekti i vjetër të kalojë në objektin e ri që është i

destinuar për këtë qëllim. Është mirë që delegatët ta votojnë dhe t'ia hapin rrugën kryetarit që ta bëjë një kontratë me Postën e Kosovës, duke u bazuar në këtë vendim, do të thotë me shfrytëzim 99 vjet, pa të drejtë për privatizim, dhe qiraja të jetë në vlerë 1 euro në muaj. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit! Kryetari ka propozue që qira të jetë 12 euro në vjet, në vend se të jetë 10 euro, domethënë 1 euro në muaj. Fjalën e ka kërkuar z.Munir Jonuzi.

Munir Jonuzi: Unë nuk jam kundër vendimeve të tilla. Por duhet të keni parasysh se posta është një kompani publike që bën fitim dhe si çdo kompani publike duhet të respektojë ligjin e punësimit. Unë nuk do ta mbështes këtë propozim sepse nuk dua të bëj lëshime ndaj këtij institucioni publik. Mendoj se ky çmim prej 12 eurosh në vit është i ulët. Unë mendoj se qiraja duhet të jetë shumë më e lartë, sepse ata fitojnë. Sa i përket arsyes së mospërkrahjes sime të një vendimi të tillë, është se në një nga kuvendet e mëparshme na kanë treguar përqindjen e punësimit të komunitetit jo-shumicë në postë. Besoni apo jo, kjo përqindje ishte vetëm 15%. Unë nuk mund të bëj asnjë lëshim për një kompani të tillë publike, dhe për ju, zoti President, e di që nuk keni lidhje me atë përqindje dhe se nuk keni autoritet të drejtpërdrejtë mbi postën, megjithatë, mund të përdorni autoritetin tuaj dhe rritjen e numrit të të punësuarve nga komuniteti joshumicë në këtë sektor.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Jonuzi! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Fjalën e ka kërkuar z.Shpetim Hajredini.

Shpetim Hajredini: Përsëritje edhe një herë për të gjithë! Kemi një propozim të ardhur nga kryetari. Unë realisht nuk jam kundër këtij propozimi, por vetëm do të bëj një lexim të shkurtë të Rregullores që ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, ta shohim nëse është plotësuar kriteri, që mos të vjen puna pastaj dhe të na kthehet mbrapsht edhe ky Vendim të cilin e ka marrë kryetari. Kemi Rregulloren Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Do të kaloj direkt tek neni 25, i cili përcakton disa kritere të cilat duhet të plotësohen nga ana e ekzekutivit. Do të thotë, shfrytëzimi i kërkesës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për rastet e veçanta, kryetari i komunës, pas pranimit të kërkesës, e adreson atë te Kuvendi i Komunës për shqyrtim dhe miratim, së bashku me materialet përcjellëse. Deri këtu jemi në rregull, do të thotë tek neni 25, pika e parë, është e para kërkesë zyrtare te institucionet përkatëse dhe e dyta është arsyetimi i interesit të përgjithshëm publik. Këto të dyjat besoj që ne i kemi, mirëpo atë që nuk e kemi, kërkesën e cila është bërë nga Posta e Kosovës unë nuk e kam në dokumentacion këtu. Ju e keni si ekzekutiv, por në Kuvend nuk na është sjellë. Këtu ky nen po e potencon që duhet të na sigurohet edhe neve. Kërkesa e Postës së Kosovës është dashtë të jetë këtu në material. Gjithashtu, deshta ta bëj edhe një pyetje.

Nuk jam shumë i saktë në këtë pyetje të cilën do ta parashtroj, sepse realisht nuk e di sa qëndron, por ka qenë po më duket tek kjo Rregullore edhe e përcaktume nga ligji, që në momentin që jepet një pronë në shfrytëzim, ta këtë edhe vlerën e 10%-shit, mos gabofsha, të investimeve kapitale të vitit paraprak. Domethënë, për qato vite për të cilat e lëshojmë ne pronën komunale, në këtë moment Postës së Kosovës, brenda atyre viteve ta investojë do të thotë 10%-shin e investimeve kapitale të Komunës. Në vitin paraprak, 4 milionë apo sa e kena pas, do të thotë i bjer 400 mijë. Te kjo ta parashtrova si pyetje, sepse nuk jam i sigurt. Ndërsa tjetër ta lexova atë që është ligjërshjt dhe që është në Rregullore. Prandaj është mirë që, nëse keni mundësi, atëherë na kompletoni tash dokumentacionin. Unë nuk jam kundër, do ta votoj pro nëse më vjen dokumenti, plotësohet propozimi ashtu si duhet ligjërshjt, nuk jam kundër. Ju falemnderit!

Uran Halimi: Faleminderit! Brenda pesë minutave na sillet neve dhe materiali që e kërkoi z.Hajredini. Gjatë kësaj kohe vetëm me njoftuan që kanë ardhë lloptopët, mundeni me i nënshkrue disa procedura të cilat janë të nevojshme, ndërsa pas përfundimit të seancës mundeni me i marrë secili. Të nderum delegatë, për shkak që kërkesa është e papërkthyme, unë është mirë me e lexue edhe pjesa e asambleistëve të komuniteteve me e dëgjue. Ne nuk i përkthejmë kërkesat e Postës. Unë po jau lexoj, përkthimin e keni prej përkthyesit të Kuvendit, edhe pastaj Zyra e Kuvendit ua shpërndanë edhe kërkesën, nëse është e nevojshme. Është e datës 25 gusht, për Komunën e Dragashit, kryetari Bexhet Xheladini, Kuvendit Komunal, kryesuesi Uran Halimi, përmes Nora Rraci – Kryeshefe Ekzekutive e Postës së Kosovës. Tema është kërkesë për dhënie në shfrytëzim të objektit të destinuar për postë në fshatin Brodosanë. Thotë kështu:

Të nderuar,

Zyra Postare në fshatin Bresanë të Komunës së Dragashit aktualisht është duke funksionuar në objektin e Zyrës së Vendit të këtij fshati, i cili objekt për shkak të vjetërsisë është demoluar në masë të madhe dhe si rezultat i kësaj nuk i plotëson kushtet higjienike dhe kushtet tjera për të vazhduar operimin në këtë objekt. Ndërkaq, sipas informatave që kemi nga Komuna, ky objekt parashihet të rrenohet, pasi në atë pjesë planifikohet të bëhet rregullimi i infrastrukturës së fshatit, duke i propozuar Postës së Kosovës që të lirojë objektin e vjetër në të cilin ka funksionuar Zyra Postare, dhe të zhvendoset në objektin tjetër i cili është i destinuar për postë nga banorët e fshatit Brodosanë. Sipas informatave që kemi nga Komuna, banorët e fshatit në vitet e '80-ta, me kontributin e tyre vetanak dhe me vetëfinancimin e tyre kanë ndërtuar objektin me destinim të caktuar për postë. Dhe që nga ajo kohë, ish-PTK, tanimë Telekomit i Kosovës, ka bërë shpërndarjen e kabllave nëntokësore të telefonisë fikse dhe tani në një pjesë të këtij objekti janë vendosur vetëm pajisje teknike të Telekomit

të Kosovës. Ndërkohë, Komuna e Dragashit ka bërë investime shtesë në këtë objekt, duke bërë rregullimin e hapësirave të brendshme dhe të jashtme, me çka janë krijuar kushtet e parshtatshme për operimin edhe të Postës dhe zhvendosjes në këtë objekt. Duke pas parasysh që me rregullimin e këtij objekti nga Komuna e Dragashit janë krijuar kushte më të mira për operimin e Postës dhe është krijuar një ambient i përshtatshëm për banorët e fshatit Brodosanë, kërkojmë nga autoritetet e Komunës së Dragashit, përkatësisht Asambleja e Kuvendit të Komunës së Dragashit, që të na japë në shfrytëzim afatgjatë objektin e destinuar për postë në fshatin Brodosanë, bazuar në Ligjin Nr.06/L 092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Shpresojmë se autoritetet e Komunës së Dragashit do ta marrin seriozisht kërkesën tonë dhe do ta aprovojnë të njëjtën, pasi që edhe mundësitë ligjore e lejojnë një gjë të tillë, duke marrë për bazë që objekti aktual i Zyrës së Vendit ku është duke funksionuar Zyra Postare, nuk i plotëson kushtet elementare për operim.

Kjo është kërkesa që na është dërguar nga drejtuesit e Postës së Kosovës, andaj neve na mbetet për me e hedhë në votim, nëse debati veç u shterrë. Nëse jo, mundeni me e marrë fjalën me bo pyetje ose çkadoqoftë. A do dikush me e marrë fjalën përpara se ta hedhim në votim? E hedhim në votim. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Konstatoj që me 21 vota pro, me zero kundër edhe zero abstenim, kalon pika e pestë e rendit të ditës. Po vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës, është Propozim Vendimi për iniciimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal. Dje kryetari na ka dhënë sqarime, është mirë edhe sot.

Qamil Kolloni: Përsëndetje kryetar, përsëndetje kryesues, përsëndetje të gjithë juve delegatëve! Propozim Vendimi për iniciimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal vjen si rrjedhojë për faktin se Komuna e Dragashit ka pas të miratuar PZhK 2013-2023. Meqenëse jemi afër skadimit të afatit të këtij Plani, si Drejtori e Zhvillimit Ekonomik kemi parapa iniciimin për hartimin e PZhK-së, i cili duhet të kalojë përmes procedurave të Kuvendit. Prandaj ne jemi munduar t'i japim edhe sqarimet, besoj që i keni lexue. Në nenin 9 që është me rëndësi, duhet ta kuptoni që në fuqi qëndron PZhK aktual, deri në momentin e miratimit të këtij Plani. Prandaj, shpresojmë që kompania e cila do të jetë e specializuar për hartimin e PZhK, njëkohësisht edhe për hartat zonale, shpresojmë që këto dy projekte t'i fillojmë gjatë këtij viti dhe t'i përfundojmë në afatin më të mirë të mundshëm kohor. Këto projekte do të ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e ekonomisë komunale. Gjithashtu, do të mund të bëjmë edhe revidimin e zonave të interesit të përgjithshëm dhe planifikimin e këtyre zonave. Besoj që bashkërisht me delegatët, me këtë Kuvend dhe me këtë ekip do t'ia arrijmë që në afatin dy-tre vjeçar ta realizojmë edhe këtë projekt.

Munir Jonuzi: Faleminderit. A don fjalën dikush tjetër? Meqenëse nuk ka diskutues të tjerë. Po e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është PRO-22, KUNDËR-0, ABSTENIM-0. Konkludoj se kjo pikë është miratuar unanimitisht. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. A don fjalën dikush? Meqenëse nuk ka diskutues të tjerë. Po e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është PRO-21, KUNDËR-0, ABSTENIM-0. Konkludoj se kjo pikë është miratuar unanimitisht. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Driton Ademi: Faleminderit, zv/kryesues! Atëherë, unë i kam disa kërkesa për fshatin Bresanë. E kam një propozim, të mjetet buxhetore të ndara (76 mijë euro), të pika 12 'Kubëzimi i rrugëve në Rrugën Luftëtarët e Lirisë dhe Rruga e Zgatarit janë të ndara 76 mijë euro. Unë kërkoj nga kryetari që të hiqen disa mjete nga pika 12 dhe i kam tri propozime: Rregullimin e shtrojave të reshetskave të Rrugës Luftëtarët 1912 (rreth 3 mijë euro), ndërtimi i murit mbrojtës në mahallën e Donajve (4 mijë euro) dhe ndërtimi i trotuarit tek vendi i quajtur *Ura e Madhe*, për shkak se është ngarkesë shumë e madhe është mirë me e bo një trotuar të ura. Unë e kam paraparë 10 mijë euro, nuk e di sa mundën me e mbulue kjo. Por është shumë e nevojshme, për shkak se fëmijët, nxënësit kalojnë kah kjo pjesë. Edhe një propozim e kisha, masi e kemi edhe drejtorin këtu, edhe vetë ke qenë në dëgjim buxhetor kryetar, shkolla është mjerisht katastrofë. Nuk e di, asnjë mjet nuk ke parapa të shkolla për investim. Është mirë me ia dhënë një ngjyrosje asaj shkollës, se është e shkruar. Nëse ka mundësi qeto kërkesat që janë pak ma urgjente, qeto triat, me i miratue është mirë. Tek pika e 12 me hek diku rreth 17 mijë euro. Po foli vetëm për Bresanë. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë! Propozim Vendimi për Buxhetin është pika më e rëndësishme e këtij viti, e këtij Kuvendi. Ju e keni marrë materialin, keni pas kohë me e shfletue, me e analizue. Por ndërkohë, nga momenti momenti kur e keni marrë materialin deri më sot kanë ardhë disa ndryshime, disa propozime të reja. Unë në Komitet i kam lexue, Komiteti i ka aprovue të gjitha, andaj edhe një herë juve si delegatë po jua sqaroj këto propozime, në mënyrë që ta keni më të qartë kur të delni me diskutue, se çfarë ndryshime janë bo në buxhet. Së pari, të pika 1 – është fjala për Listën e projekteve – në vitin 2026, ku shkruan 2,484,290 duhet të jetë 2,234,290. Këto mjete shkojnë në pozicionin e ri 56, që na ka ardhë me vonesë prej Qeverisë ky propozim dhe na kanë lut me e ndryshue. Do të thotë janë hek 250 mijë dhe këto mjete janë vendos në një pozicion të ri 56, për ndërtimin e shtëpive të personave me aftësi të kufizuara. Të pika 12 kanë qenë 76 mijë, duhet me qenë 72 mijë. Këtu ku e kemi qit 72 mijë, mundemi me i fut propozimet e asambleistit nga Bresana, vetë, ia shtojmë emrat e mureve, trotuarit edhe atyre reshetskave. 4 mijë euro që janë hek nga pozicioni 12, janë qit në pikën 14, të ndërtimi i shtëpisë turistike të Pishat. Do të thotë 12 mijë kanë qenë vitin

e kaluar, 10 mijë nga të hyrat vetanake dhe 4 mijë nga Granti, krejt bëhet 26 mijë euro. Te numri 24, përveç asaj, veç të shtohet fjala ‘..dhe kubëzimi...’. Te pika 29, të shtohet muri mbrojtës në Qollopek dhe kanalizimi. Te pozicioni 34, te kubëzimi i rrugëve në fshatin Plavë, të shtohet edhe rregullimi i Përroit të Kreveqicës. Kanë qenë 33 mijë euro, duhet të jenë 20 mijë euro, 13 mijë euro të shtohet pozicioni i ri, projekt dyvjeçar – ndriçimi i fshatit Plavë. 10 mijë janë këtë vit, edhe 13 mijë vitin e ardhshëm. Do të thotë pozicion numër 57. Te pika 47, për vitin 2025 të shtohet 70 mijë euro në projektion. Tjera ndryshime nuk ka. Ju e dini që shumica dërmuese e buxhetit shkon për Ujësjetllësin për 15 fshatra dhe qytezën e Dragashit. Ky është projekt të cilin unë e kam trashëguar dhe ne si qeveri e re jemi duke e implementuar projektin e vitit 2012. Nëse dikush heziton që për shkak të Ujësjetllësit të mos e votojë buxhetin, duhet t’i rikujtoj se vitin e kaluar kjo Asamble, me vota unanime, 27 për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, i ka ndarë 500 mijë euro për ndërtimin e Ujësjetllësit për 15 fshatra edhe qytezën e Dragashit. Do të thotë, ata të cilët hezitojnë me e votue buxhetin për shkak të Ujësjetllësit, unë dua t’ua rikujtoj se këta vitin e kaluar kanë votuar për këtë Ujësjetllës dhe ky projekt që është duke u implementuar nuk ka ndryshue asnjë milimetër, është i njëjti projekt. Vetëm ka ndryshue shuma e mjeteve, do të thotë kur është bërë në 2012-tën ka kushtue pak ma lirë, tash kushton pak ma shtrenjtë, gjë që është normale. I ftoj delegatët që buxhetin ta votojnë të gjithë, unanimit! Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Jetmiri e ka kërkuë fjalën, pas tij znj.Ventaza dhe pas saj fjalën e ka z.Artan Loshaj.

Jetmir Ajdini: Përshëndetje të gjithë! Atëherë, jemi te pika e rendit të ditës për miratimin e buxhetit. Së pari, në këtë buxhet, prej investimeve që do të bëhen në fshatin Zgatar, kisha disa propozime. Janë planifikuar 20 mijë euro për mur mbrojtës në Rrugën *Kuji i Mullinit* dhe janë planifikuar diku 7 mijë euro për kanalizime dhe infrastrukturë përcjellëse. Propozoj që këto mjete që janë destinuar për kanalizim, të ridestinohen në një projekt tjetër që është shumë ma me rëndësi, është pjesa e *Rrugës së Serdonit* që ka nevojë për një mur mbrojtës, te shpia e familjes Samidin Emini. Ka nevojë aty për një mur mbrojtës, se është pjesë që ka lagështi dhe rrezikon me rrëshqit. Vlera është 7 mijë euro që janë planifikuar për kanalizim, është mirë të ridestinohen, ndoshta edhe të rritet kjo vlerë që të ndihmojë atë pjesë të murit mbrojtës aty. Sa i përket buxhetit, na po e dimë që shumica po shkon për investime në Ujësjetllës. Është vlerë e madhe që përfshinë këtë vit, vitin tjetër edhe vitin 2026. Fshatrat mbesin me shumë pak investime për shkak të investimit në ndërtim të Ujësjetllësit kryesor për 15 fshatra që përfshihen. Unë prapë propozoj që ju si Qeveri Komunale të bëni ndonjë kërkesë ministritë përkatëse dhe të na mbështesin edhe ata me buxhet në ndërtimin e këtij Ujësjetllësi, e jo i

gjithë buxheti komunal të na shkojë në investime për Ujësjellësin dhe fshatrat të mbesin pa investime, ose me investime minimale. Nuk e di e keni planifikuar që të bëni ndonjë kërkesë në ministri që ata të na mbështesin me mjete financiare që ky projekt të përfundojë edhe fshatrat e Komunës sonë të mos mbesin me shumë pak investime. Faleminderit!

Ventaza Esati: Përshëndetje të gjithëve, vërej se nuk janë ndarë mjete për fshatin Leshtanë për vitin e ardhshëm. Mjetet e destinuar për Leshtanë janë të dedikuara për rrugën e përbashkët mes Leshtanës dhe Radeshit. Të gjitha mjetet janë ndarë nga buxheti i dedikuar për fshatin Leshtanë. Përkundër kësaj, nuk e di nëse është marrë edhe pëlqimi i pronarëve të parcelave në rrugën Leshtanë Radesh. Dhe nëse këto mjete do të ishin të gjitha për fshatin Leshtanë, do të ishin të vogla në krahasim me madhësinë e fshatit dhe numrin e banorëve të fshatit Leshtanë.

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! Zotëri kryetar, kam qef me dëgjue, se i pata nja dy-tri pyetje për ju. Nuk po due me vazhdue shumë, kryetar, po në këtë Listën e shpenzimeve kapitale deshta nja dy-tri sqarime, në qoftë se ka mundësi. Nën 3, Asfaltimi i rrugës Brrut-Zgatar dhe rregullimi i rrugëve të asfaltuara Kuk-Kosavë-Pllajnik ... janë nja dhjetë fshatra, me 7,500 euro s'po e kuptoj, veç me bo deni foto, me bo me dalë, edhe për foto s'ju dalin këto pare, për dreka e darka s'ju dalin. S'po e kuptj qeto. Nën 5, ndërtimi i parkut në Dragash (25,500), sa parqe në Dragash, se unë jetoj qetu edhe s'po i di. Çdo vit ndërtoini parqe, nime, sa janë këtu në Dragash. Unë e di që dy parqe janë, nja dy-tri veç i keni ndreq edhe sivjet edhe një e keni, s'po e di cili është. Nëse ka mundësi ma hollësisht pak me m'kallxue cilin park në Dragash 25,500 euro. Nën 6, ndërtimi i rrugëve në qytezën e Dragashit nga Sheshi i Dëshmorëve dhe Rruga Unazore në Dragash (55 mijë euro). Për çdo vit jemi t'u investue qetu, s'po e di çka do të bëjmë aty. Kemi bo parkun, i keni bo sivjet ato lulat e famshme pa komë, keni bo shumë sende. Qetash edhe 55 mijë euro. Në qoftë se ka mundësi ti me m'spjegue është mirë. Edhe, masi filluet krejt me bo lokalizëm, po dal te Rrenci. Nën 35, kubëzimi i rrugëve në fshatin Rrenc. Nashta je konsultue qetash, se je kryetar, je konsultue edhe me zonjën, unë e di që në Rrenc mo s'besoj që ka me bo kubëza, a është mirë me bo ndriçim publik, në qoftë se ka mundësi. Në qoftë se je konsultue me qytetarët edhe me asambleisten, me më kallxue mu ku janë ato rrugë, s'ka problem e votoj, se s'jam kundër unë. Ama unë besoj që në fshatin Rrenc nuk ka mo vend për kubëzim, besoj mo që vakti edhe koha është për një ndriçim publik. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Loshaj! Fjalën e ka kërkuë z.Nedžmidin Sejdilar.

Nedžmidin Sejdilar: Të nderuar të pranishëm, keni pasur më shumë se 3 muaj kohë për të përgatitur buxhetin dhe sërish në minutat e fundit po bëni ndryshime në buxhet. Ajo që më ka habitur më shumë është se i vetmi send që keni ndryshuar në Gorë ishte parashikimi i buxhetit për vitin 2025. Kjo do

të thotë, hajde, bëhu mirë, dhe ne do t'ju çojmë të shikoni fëmijët duke ngrënë akullore. Një gjë tjetër: Numri pesë është ndërtimi i një parku në Dragash. Po i referohemi atij parku atje, ngjitur me varrezat apo në varreza, sido që të jetë, i njëjti park që qytetarët pas këtij podiumi ju kërkuan që të mos ndërtoni park në atë vend. Qytetarët erdhën këtu dhe ju thanë se nuk duan të ndërtohet ai park. Ata organizuan edhe një peticion për parkun, kjo është edhe më keq, dhe ju nuk i jeni përgjigjur akoma. Lidhur me atë peticion, ju e leni zotin Rahta ta zgjidhë çështjen dhe të zgjidhet në mbledhjen e ardhshme me shpresën se do të harrohet. E di që ju keni votat për të miratuar këtë buxhet dhe nëse dëshironi, mund të ndërtoni edhe ura nëpër fshat. Por unë nuk mund të rri i qetë dhe i heshtur nga ulese pa ju bërë këto pyetje. Pika e tretë dhe më e rëndësishme ka të bëjë me furnizimin me ujë. Ju thatë se disa delegatë këtu nuk e duan projektin e ujësjellësit. Le ta kuptojmë këtë. Të njëjtën gjë thashë dje në komision. Ne delegatët e Gorës nuk jemi kundër ndërtimit të ujësjellësit. Ne mbështesim ndërtimin e ujësjellësit. Në Gorë nuk ka asnjë person që është kundër ndërtimit të ujësjellësit qendror për ato vende që kanë probleme me ujin e pijshëm. Por jo për të ndërtuar ujësjellës në ato vende që nuk kanë probleme me ujin e pijshëm, ato fshatra që i kanë zgjidhur ato probleme. Ju vetë zoti President thatë se atë projekt e keni trashëguar nga qeveria e kaluar. A do të thotë kjo se qeveria juaj është një kopje e asaj të mëparshme? Ju nuk keni fare projekt, keni trashëguar projektin e qeverisë së kaluar, që nuk them që nuk është as i mirë as i keq. Në takimin publik të qytetarëve të fshatit të përfshirë në ujësjellësin pas këtij folësi, përfaqësuesit e fshatit thanë se nuk kanë probleme me ujin e pijshëm. Se nuk është e nevojshme të kryhet ujësjellësi në Vranishte. Ai përsëri thekson, as unë e as askush nga Gora nuk jemi kundër ujësjellësve apo fshatrave që kanë probleme me ujin e pijshëm. Deri më tani nuk kemi folur për para për furnizim me ujë. Folëm pse duhet të shpenzojmë para për fshatrat që e kanë zgjidhur problemin ose thjesht nuk duan ujë. Ne jemi këtu për të përfaqësuar interesat e tyre. Ju dhe komisioni juaj certifikuat përfaqësuesit e fshatit kur zgjedhët kishallat e fshatrave. Ata erdhën këtu dhe ju refuzuan. Ne nga Gora absolutisht nuk jemi kundër që asnjë qytetar i komunës së Dragashit të ketë ujë. Ju lutem kuptoni se çfarë po them. Mos i keqinterpretoni fjalët e mia më pas. Unë jam i vetëdijshëm që banorët e Opojës kanë probleme me ujin e pijshëm, jam këtu për t'i takuar, por duhet të biem dakord, të mos terrorizojmë ata njerëz që nuk duan ujë. Paratë nga buxheti nuk janë problem. Nëse qytetarët e Opojes kanë nevojë për para, ne do të japim hua. Po pse të hedhim para aty ku nuk ka nevojë. Në mbledhjen që drejtuat ju, njerëzit ju refuzuan për këtë ujë të pijshëm.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Sejdilar! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Fjalën e ka kërkue z.Shpetim Hajredini, pas tij fjalën e ka z.Samidin Xheladini.

Shpetim Hajredini: Atëherë përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Sot po diskutojmë për një material shumë të rëndësishëm, për materialin më të rëndësishëm të vitit, pra miratimin e Buxhetit të Komunës së Dragashit për vitin 2024 dhe vlerësimet për vitin 2025 dhe 2026. E kam diskutuar edhe në lexim të parë, do të thotë në qershor, atëherë kur vetëm kemi filluar të diskutojmë për buxhetin dhe investimet kapitale të cilat do të kryhen për vitin 2024, se për mu ky Buxhet apo kjo Listë e shpenzimeve kapitale, kjo ndarje buxhetore nuk është në rregull. Tani kam lexuar prapë me përpikmëri, dhe me kujdes të veçantë kam shikuar nëse është bërë ndonjë ndryshim të cilin e kam kërkuar në qershor, por nuk kam hasur diçka të tillë. I nderuar kryetar, ti në atë kohë ke qenë në vend të shenjtë dhe nuk ke qenë pjesë e Asamblesë, ndërsa drejtori i Financave ka qenë dhe e di për kërkesat e mia të cilat i kam bërë në atë seancë. Prandaj unë detyrohem edhe një herë të rikthehem mbrapsht dhe të kërkoj edhe tani, edhe pse realisht unë e di që nuk do ta kem mbështetjen, por jam i detyruar sepse jam këtu për të mirën e qytetarëve. I nderuar kryetar, kemi një buxhet mjaft të mirë, prej 12 milionë, mirëpo ndryshimet tek dy sektorët kryesorë të cilët bëjnë hapjen e vendeve të reja të punës, e din edhe ti personalisht vetë, ke dhënë edhe premtim gjatë fushatës zgjedhore, janë bujqësia dhe blegtoria. Në këtë buxhet nuk ka ndryshim, shumat janë pothuajse të njëjta në këtë Drejtori. Subvencionet të cilat do t'i ndihmonin fermerët janë gjithashtu të njëjta. Diskutojmë dhe kemi ankesa gjithmonë edhe për shëndetësinë dhe buxheti është pothuajse i njëjtë. Kisha pas dëshirë që edhe këtu të ketë rritje, por për fat të keq nuk kemi. Natyrisht, jam i detyruar që të diskutoj edhe për projektet të cilat prekin fshatin tim. Janë dy projekte, realisht e pashë që kemi rritje në krahasim me atë që na është pru në qershor, nga 50 mijë tani kemi kaluar në 69 mijë, ku janë dy projekte kapitale të cilat pritet të përfundojnë në vitin 2024. Ndërtimi i ujëmbledhësave në vendin *Guri i Gatë* - këto të cilat i kuptojmë vetëm ne të cilët jemi prej fshatit Kuk dhe të cilët kanë njohuri për këto pozicione të cilat ekzistojnë në bjeshkë - dhe kubëzimin e Rrugës *Samidin Emini* në fshatin Kuk. Dy rrugë 49 mijë, ndërsa tek ujëmbledhësat 20 mijë. Unë kam pak njohuri rreth shumave të cilat janë përdorur në katër vitet e kaluara për ujëmbledhësat dhe qeky 20 mijëshi realisht, për mu, nuk besoj që do t'i mbulojë këtë projekt i cili përfshinë dy kaptazha apo dy ujëmbledhësa. Me 20 mijë nuk e di nëse do të konkurojë ndonjë kompani për t'i realizuar. Por edhe po qe se do të konkurojë, unë personalisht, ju e dini që – po edhe dy katundarët e mi sot qenkan, ta Kapllan dhe Resuli – e dinë që unë nuk t'u ndërhy në projekte të cilat i kanë pru njerëzit e fshatit. Desha vetëm të jap një këshillë, nëse dojnë ta pranojnë dhe ta marrin. Unë jam i bindur se fshati Kuk për ujëmbledhësa nuk ka nevojë, i ka të mjaftueshëm. Fshati Kuk ka nevojë për pastrim të ujit, ka nevojë për ndërgjegjësim të njerëzve, se ujë ka të mjaftueshëm. Për kaptazha, të themi të drejtën, janë të tepruara. Ka mjaftueshëm kaptazha,

por tani është planifikuar. Përndryshe, po të kisha qenë unë, nuk do të kisha lejuar që të vazhdohet me ndërtim të kaptazhave, kur kemi nevojë edhe për shumë projekte tjera të cilat janë të nevojshme brenda fshatit. Kemi lumin, i cili është i tmerrshëm, i bllokuar në tërësi, që po që se vjen ndonjë ujë – ishalla nuk do Zoti – i tepërt nga lart, neve ka me na marrë të gjithëve. Kishte qenë një projekt shumë i arsyeshëm që të bëhet pastrimi i lumit. Gjithashtu, kemi bërë edhe në një punë, por nuk është punuar si duhet. Këndi i lojtrave për fëmijë. E kanë bërë në mënyrë të përsheptuar dhe nuk ka qenë si duhet. Atë e pranoj, mirëpo tani është dëmtuar totalisht nga fëmijët. Edhe ky kishte qenë një projekt, i cili është shumë i nevojshëm për ata fëmijë të cilët për momentin janë në fshat dhe që nuk dihet, viti-vitit vetëm po largohen të gjithë. Por për momentin, ata të cilët janë aty të kenë një vend ku do të mund ta kalonin kohën e lirë. Kam edhe diskutime tjera, të cilat kanë të bëjnë me fshatin, por nuk lidhen me Listën e shpenzimeve kapitale të cilat do të kryhen për vitin 2024. Prandaj, po e lë që ato pyetje dhe ato shqetësime t'i parashtroj në eventuale. Ju falemnderit!

Samidin Xheladini: Të nderuar delegatë! Unë si zakonisht, kur vjen puna e buxhetit kurrë nuk bëj kërkesa, as nuk kam bo 14 vjet. Për shkak se qeveria i di punët e veta edhe është mirë që na kemi dhënë kontributin që na u dhënë mundësia. Duhet me e ditë dhe me e falënderue Zotin që na ka dhënë mundësinë na të jemi edhe këtu prezent, si delegatë edhe si qeveri, që e miratojmë një buxhet që në vazhdimësi ka qenë – prej se jam unë delegat këtu – ka qenë ujësjellës, ujësjellës. Çdo herë e kemi votue unanimisht, për arsye se është nevoja vitale. Tash, fshatrat që po paraqiten shqetësime, ato fshatra që s'dojnë – na do t'jau çojmë ujin, na, jo qeveria, na krejt, se na po e votojmë, qeveria e ka për detyrë me punue. T'ia çojmë ujin çdo fshati, t'ia krijojmë kushtet. Njëjtë ka pas edhe me mbeturinat, edhe kanë bo zhurmë, se duhet me pague. Por tash krejt po e shohin që ka qenë shumë e mirëseardhur. Edhe për ujin, uji rri aty, kush do e merr, kush do s'e merr. Domethënë qeveria po ua ofron, këta ose e marrin ose s'e marrin. Edhe kemi raste në historik, në qoftë se bëhet qe ky ujësjellës, na do ta ndijmë veten shumë mirë. Është një person në fshatin tonë, baba i Fesalit, Sabri e ka pas emrin, ai mbahet hero i ujit në Bresanë. Edhe në çdo katund dikush që bën kontribut. Edhe na duhet ta japim kontributin edhe të mos votojmë kundër. Krejt qeveritë janë angazhue me pas ujë, edhe Salimi edhe Shabani edhe krejt, me e bo Ujësjellësin. Nuk kanë mund, jo për hir që s'kanë dashtë, por që kanë pas procedura gjyqësore, kanë pas konteste. Tash ato janë hek, domethënë na kemi mundësi me e bo, me e votue unanimisht. Në qoftë se s'e votojmë na, për shembull në qoftë se unë s'e votoj, mbes në histori që unë jam konë kundër Ujësjellësit. Kjo në opinion shfaqet pastaj. Këtë deshta me e thonë, na duhet me debatue, me i shqyrtue, krejt në rregull. Ujësjellësi s'është problem pse shkon deri në fshat. Le t'i shkojë, ai munden mos me u kyç, ka ujë, ka të drejtë mos me u kyç,

është në rregull krejt. Ka edhe plotë te na, për shembull, që kanë burime vetanake, po e ka edhe ujësjellësin qendror, kur t'i duhet. Ju falemnderit!

Uran Halimi: Falemnderit, z.Xheladini! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Fjalën e ka kërkuar z.Munir Jonuzi.

Munir Jonuzi: Zoti Kryetar, më interesojnë dy pyetje. Ju dëgjova me vëmendje, shkova me ju në takime, morëm listën e investimeve kapitale, thotë se kemi 11639 euro për rehabilitimin e rrugës Krushevë-Barbulë. Ky është propozimi që ju i keni dhënë qytetarëve për inspektim. Dhe propozimi i dytë, trasimi i rrugës në hyrje të fshatit Restelicë, 170.000 euro. Më intereson se ku janë këto projekte.

Uran Halimi: Falemnderit, z.Jonuzi! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Fjalën po e marr unë. Të nderum delegatë dhe ekzekutiv! Unë dola të flas në lidhje me buxhetin e ndarë për fshatin Blaç. I kemi këtu te kolona 9, 10 edhe 11, është kubëzimi i rrugëve te Rruga e *Livadhit Begit* edhe në kodër të fshatit Blaç, janë parapa diku 44 mijë euro; Rregullimi i ujëmbledhësave dhe renovimi i kaptazhave të ujit në vendin *Gjybra e Pashës, Brezhda* në fshatin Blaç; te kolona 11 e kemi ndërtimin e parkut në Rrugën *Shkëndija* në mahallën Prifte të fshatit Blaç. Siç e dini, unë edhe vjet kur është miratue buxheti kam ardhë këtu me një kërkesë të vetme të kryesisë së fshatit Blaç. Për këto investimet e parapame jam i sigurt se nuk është kontaktue kryesia e fshatit Blaç. Nuk e di kush i ka parapa këto. Kërkesa e vetme për investime në fshatin Blaç ka qenë rregullimi i kaptazhave, me qëllim që me u kushtëzue në njëfarë mënyre qeverisja. Rregullimi i kaptazhave ka qenë e parapame edhe vitin që ne po e lëmë pas, edhe asgjë s'ka ndodhë. Ajo çka më bëri përshtypje është se në rregullimin e kaptazhave e pashë që në vitin 2022 veç është intervenu. Kam shku e kam këqyr vendin e ngjarjes, nuk ka të intervenumë kurgjo në kaptazhat e ujësjellësit të fshatit Blaç, ndërsa në dokumentacion ajo punë veç është krye. Këtë edhe munda me jau dëshmue, e kam edhe kontratën e nënshkrume. Kaptazhët janë parapa me e rregullu vitin e kalum, me atë ujësjellësin që ka dalë prej bjeshkës së fshatit Blaç, për në Shtavë aty janë konë të parapame edhe rregullimi i kaptazhëve, sepse ai ujësjellës që ka dalë prej bjeshkës në Shtavë e ka vetëm një kaptazh. Ndërsa te projekti janë parapa rregullimi i kaptazhëve, janë ndarë fonde aty. Unë po besoj që anashkalimi i kryesisë së fshatit Blaç në lidhje me këto investime, ka ndodhë me qëllim që prapë puna e rregullimit të kaptazhëve të qëndrojë në heshtje, ndërsa të rregullohen punë tjera të cilat, jam i sigurt, e kemi këtu prezent edhe kryetarin e fshatit Blaç, vetë ma dëshmoi që nuk ka bo kërkesë të ngjashme. E vetmja kërkesë e qytetarëve të fshatit Blaç ka qenë rregullimi i ujëmbledhësave ose kaptazhëve. Investimet tjera të parapame janë të shtime në mënyrë... nuk e di as qysh me e gjet këtë mënyrë. Andaj, i nderum kryetar, edhe ju

ekzekutiv, është mirë që kërkesa e vjeme po përsëritet prapë, domethënë në plan na kemi pas vjet me i rregullue kaptazhët, a po? S'janë bo, janë shtue do pare veç, sa me i qit hi syve qytetarëve të fshatit Blaç, po vazhdon edhe në mot i njëjti projekt. Më e keqja që është investue në ato kaptazhe me dokumentacion, po me punë jo. I nderum kryetar, unë e kam një kërkesë, që në kolonën e 9-të, kubëzimi i Rrugës *Livadhi Begit* edhe të *Kodrës* në fshatin Blaç, nga këtu të merren 14 mijë euro, e kam një propozim. Aty te *Ura Haxhisë* na ku i themi, është një qytetar, ka ndërtue shtëpi që 2-3 vjet aty edhe jeton, nuk ka rrugë, edhe e shoh të arsyeshme që, prej 44 mijë euro, me i nda 14 mijë euro edhe me e fillue rregullimin e *Rrugës Haxhisë* për në *Kodër* të fshatit Blaç. Ndërsa planifikimi që është bo me 44 mijë euro, i bjer që na po e vazhdojmë rrugën përpjetë, ndërsa më poshtë e kemi një rrugë të parregullume, rrugë kjo e cila do t'iu kishte shërbye shumë qytetarëve për pronat bujqësore, por edhe për ndërtime të shtëpive aty. Është një zonë e mirë, e cila munden me u rregullue edhe me u banue, nëse na kontribuojmë në infrastrukturë. Kaq, kërkesa ime e vetme është kjo, që nga 44 mijë euro që janë të parapame në kolonën 9, të ndahen diku 14 mijë euro që krahas atyre rrugëve te *Livadhi Begit* edhe në *Kodër*, të hapet të paktën, ose të fillojnë punimet për me e lidhë edhe Rrugën e *Kodrës* me *Uran e Haxhisë*. Faleminderit! Përveç kësaj, deshta me shtu edhe në lidhje me këshillat e fshatrave që i kemi formu. Në aspektin ligjor jemi në rregull, e kemi krye atë punë, kam qenë pjesë e atij Komisioni, e dini ju të nderum delegatë. Mirëpo, është mirë që ata këshilla të respektohen edhe, kur të bëhen debatet ose dëgjimet publike në lidhje me projektet kapitale nëpër fshatra, të paktën të merren kërkesat edhe të qytetarëve, përmes këshillave të fshatrave. Në këtë rast, këshillin e fshatit që e kemi, e pyeta dhe ekstra e ftova, meqenëse kish qëllue në Dragash, ma mohoi të ketë bo kërkesë përveç rregullimit të kaptazhave. Qytetarët e fshatit Blaç dojnë veç ujë me pas. E kanë pas kërkesë të vazhdueshme këtë dhe është një investim shumë modest, dy-tre kaptazha kanë me u rregullu. Në dokumentacion më erdhi, unë kesh i pashë realisht, nuk ka të rregullume kurgjo aty. Kështu që, është mirë, le të jetë prioritet kryetar, këto investimet tjera s'është problem, le të bëhen edhe këto, unë s'jam kundër këtyre investimeve tjera, mirëpo s'mundish me më dhënë mu diçka që s'po e due. Ose s'mundish me ma dhënë ëmbëlsirën para gjellës. Kjo s'po më pëlqen. Të nderum delegatë, nëse keni dikush tjetër me shtu? Nëse s'është problem, një minutë e ka kërkuë Nedžmidin Sejdilar dhe Shpetim Hajredini.

Nedžmidin Sejdilar: I nderum kryesues, faleminderit! Zoti të ka çu me këtë fjali këtu, se qetash unë lidhem me ty bashkë. Samidin, na krejt e dimë se uji ka me na çu në Xhenet ose jo. Edhe mos provoni me më qit karshi qytetarëve të Opojës njeri destruktiv. Unë haptas po ju them këtu, unë jam pro Ujësjiellësit, po unë nuk jam për me gjujt pare ku s'duhet. Kryesues, qato që tha ti, këshillat e

fshatrave ju i keni çertifiku, ju jeni konë pjesë e atyre komisioneve. Qata njerëz pikërisht kanë ardhë këtu, jau kanë thonë juve, kryetari e ka udhëheq mbledhjen, jau kanë thonë na e kemi rregullu problemin me ujin, s'ka nevojë me çu ujë andej. Masi s'ka nevojë ujë me çu andej, shpëtojmë kohën, shpëtojmë mjetet financiare, jau rregullojmë më shpejt ujin, Ujësjellësin qytetarëve të Opojës. Kryetar, nuk është e nderhme qeshtu me ndërhy në fjalë. Unë muj edhe qeshtu me debatu, po nuk është niveli për ju i mirë, se unë ëprej rrugës kam ardhë, ju jeni njeri i edukum. Qaty kemi pak dallim. Dhe, qetash po ju them edhe një herë, ne të Gorës, asnjë njeri i Gorës nuk është kundër me pas Opoja ujë. Po na kemi bre ujë. Nuk mujm na me shkue në kafe qetash edhe me thonë 'Nexho, hajde pi birra!'. Po s'po du birra me pi, është shumë e thjeshtë, po du çips me hongër. Nuk e di ku është problemi. Na nuk e kemi problem me buxhet, kemi problem me strukturën e Ujësjellësit. Po, nashtë është e vërtetë, para dymbëdhjetë vitesh ka pas nevojë, ka pas problem. Qetash mo as njerëz nuk kemi për qat ujë që e kemi kapacitetin, e jo me bo Ujësjellës tjetër. Aty është problemi, edhe plus njeriu a ju ka ardhë vetë këtu, a ju ka thonë fshati i kemi mbledhë 30 mijë euro – po kryetar, qaty jem konë ulet, u konë edhe qeky zotnia qaty, nuk mundeni me fsheh atë – unë e di me qato 2 mijë euro me të zezë që jau keni dhonë qatyne OJQ-ve, i keni ndalu mediat me incizu, po ato nuk fshihen. Unë po ju them edhe një herë, na jemi pro qytetari i Opojës me pas ujë, na në Gorë s'e kemi atë problem edhe po ju lusim t'i konsideroni ato fakte. Paret nuk janë problem, ec ulemi edhe i rregullojmë paret, po po ju them për sistemin e Ujësjellësit s'kemi nevojë. Faleminderit!

Shpetim Hajredini: Atëherë shkurtimisht, unë në fjalimin paraparak bëra një lëshim dhe nuk diskutova për projektin e Ujësjellësit dhe të prononcohem për atë se do të jem pro apo kundër. Unë për ujin nuk kam të drejtë as moralisht që të jem kundër, se të gjithë duhet të kemi ujë. Mirëpo, në momentin që fshati Kuk ka një shumë të tillë investive për vitin 2024, mu aty më pritet rruga dhe nuk mund ta votoj këtë buxhet. Patjetër, po të kish qenë deri të 100 mijëshi, 110 mijëshi, absolutisht nuk do ta kisha diskutuar dhe do ta kisha votuar. Edhe pse unë kam prit që për vitin e ardhshëm investimet në fshatin Kuk të shkojnë në asfaltimin e Rrugës së Bjeshkës dhe të përfundohet ai projekt në mënyrën ma të mirë të mundshme, po shihet që projekti do të përfundojë këtë vit, ashtu si është për momentin dhe në vitin e ardhshëm nuk do të ketë investime në atë rrugë. Prandaj, po më vjen shumë keq realisht që vota ime do të jetë kundër, por jo kundër projektit të Ujësjellësit. Do të jetë kundër ndarjes buxhetore që është bërë për fshatin tim. Ju falemnderit!

Samidin Xheladini: Dje në Komitetin për Komunitete e kemi zgjat mbledhjen përmi dy orë. Edhe ka pas debate shumë të mira, konstruktive dhe qëllimmira. Pjesa dërmuese e debatit ka qenë në lidhje me Ujësjellësin. Edhe kolegët që janë prezent, që kanë qenë aty, kanë dhënë kontributin maksimal

që me u zgjidhë ky problem. Edhe na kanë njoftue me ecuritë se qysh ka shkue diskutimi publik etj. Unë dje ju tregova edhe këtyre, për herë të parë kam dëgjue dje në Komitet se kanë shprehë dëshirën disa fshatra për mos me u kyç në Ujësjellës. Dhe aty ju kam tregue që na në fshatin Bresanë, ju tregova, ju e dini të gjithë se fshati Buzez merr ujë prej një burimi të fshatit Bresanë dhe prej lumit të fshatit Bresanë. Kur ka ardhë me i dhënë ujë Buzezit, prej fshatit Bresanë, ka pas njerëz të cilët nuk kanë dashtë. Për me e ditë realitetin qysh është në terren, në popull, na kemi organizue referendum. Kemi shkue shtëpi më shtëpi, kemi marrë me nënshkrim të familjarëve, kush është për me ia lejue fshatit Buzez me e marrë ujin prej lumit. Dhe 95-98%, bile ma shumë, janë deklarue që me ia dhënë ujin Buzezit, deri në zgjidhjen e problemit. Na po të kishim pas kohë, këtë problem e kishim zgjidhë, si Komunë po flas, si qytetarë. Kishna shkue fshat më fshat dhe e kishna marrë mendimin, edhe referendum kishna bo, se është një çështje madhore. Po tash, në këtë moment na duhet me e aprovue, po edhe në qoftë se ndonjë fshat shihet që s'po do me e pas, mjetet shkojnë në suficit bre. Nuk harxhohen mjete, nuk ka me shkue qashtu, qajo pjesë e projektit që revidohet, qajo pjesë mundin këta me e bo, megjithëse kanë me lyp edhe ato fshatra me u kyç në të ardhmen. Se aty është e mirë, vjen uji, në kohë të ndryshme ka me pas mungesë të ujit dhe furnizimi mandej ka me konë me një pagesë simbolike. Na që e kemi ujësjellësin tonin, në momente edhe na kemi probleme me ujë. Prandaj, është e mirëseardhur qeto fshatra le të përfshihen, edhe fshatrat tjera duhet me mendue me u kyç. Kemi me e pa vetë na që në të ardhmen kanë me kërkue edhe fshatrat tjera me u kyç në rrjet. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Samidin Xheladini! Fjalën e ka kërkue Kryetari Xheladini.

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, po filloj me Ujësjellësin. Kjo Asamble, para një viti, me vota unanime ma ka dhënë dritën jeshile mu, si kryetar i Komunës, që të vazhdoj me projektin që e ka nis qeveria e kaluar. Para një viti edhe Sejdilari ka votue që Dragashit, Xërxes, Rrencit, Kapres, Bellobradit, Brrutit, Zgatarit, Kërstecit, Rapçës, Plavës, Breznës, Libevishtit, Kukajanit, Mlikës, Vraniçit dhe Leshtanit, i njëjti ka votue për me e fillue unë procedurën me e vazhdue Ujësjellësin. Edhe i ka ndarë 500 mijë euro për këtë vit, edhe në projeksion kanë qenë edhe 2 milionë euro për vitin e ardhshëm. z.Nedžmidin Sejdilar është flamurtari, i cili qe tre muaj ka bërë propagandë të madhe nëpër Gorë kundër Ujësjellësit. Po më vjen keq që disa delegatë kanë ra pre e këtij delegati, i cili është duke bërë çmos, duke shkuar edhe nëpër studio serbe atje, me proklamue se gjoja se ne po ua marrim ujin këtyre. E drejtë e tij është, munden edhe me votue kundër, por para një viti mu ky më ka detyrue unë me e fillue këtë Ujësjellës. Vota e tij, 27 vota kanë qenë pro. Nuk është problem, e imja është me e pru buxhetin këtu, e juaja është me e votue ose mos me e votue. Propozimet që i

dhashë unë, me ndryshimet që i lexova në fillim, kërkoj nga delegatët që ato ndryshime të miratohen. Gjithashtu, këtu pat edhe propozime tjera. Nga pika 43 të hiqet fjala ‘Radeshë’, të lihet vetëm ‘Leshtan’. Te kubëzimin në Rrenc, të hiqet dhe të shtohet ndriçimi publik. Te muri mbrojtës në Zgatar, nuk ka nevojë pozicione tjetër, aty na kemi mur mbrojtës, edhe ia shtojmë edhe emrin, ‘Ndërtimi i murit mbrojtës te Përroi i Serdonit’. Ne planifikojmë që ta fitojmë vitin e ardhshëm Grantin e Performancës, planifikojmë shumë më shumë pare se që kemi fitue vitin e kaluar, edhe me Grant të Performancës të gjitha ato fshatra që kanë marrë pak buxhet do t’i shtojmë mjetet. z.Munir m’i boni dy pyetje, Barbulla ku janë 11 mijë euro. Barbullës ia kemi hek 11 mijë euro, se këtë po e bëjmë sivjet, do të thotë i kemi nda 10 mijë euro këtë vit edhe tenderi ka dalë, pritet këto ditë me u lidhë kontrata me fituesin e tenderit edhe Barbulla do të kryhet sivjet. Ndërsa, sa u përket atyre mjeteve 170 mijë euro që kanë qenë të parashikume në Restelicë, 60 mijë euro i kemi lënë për kubëzimin e rrugëve në Restelicë. Ka qenë kërkesë e qytetarëve të Restelicës në debatin publik, debatin e fundit që e kemi bërë. Tjerat mjete janë shpërnda në projekte të ndryshme në regjionin e Gorës. Urani e dha një propozim, tha rregullimi i kaptazhave. Paramasa dhe parallogaria për këtë rregullimin e ujëmbledhësave është 10 mijë euro, na i kemi shtue 15 mijë. Është mbajt debati publik, kanë marrë pjesë qytetarët e fshatit Blaç, ka qenë edhe kryetari i fshatit, e ka dhënë propozimin edhe ka shkue, propozimet tjera kanë ardhë prej qytetarëve të fshatit. Ndërsa sa i përket Rrugës te *Ura Haxhisë*, do të thotë na te 44 mijëshi e shtojmë edhe këtë emër, vetëm i shtohet emri, hapja, rregullimi, kubëzimi. Këto janë ato ndryshimet unë i propozoj që delegatët t’i votojnë. Tjetër, vetëm nëse pat ndonjë pyetje, nëse kam harrue, po ai që ka bo pyetje më doket nuk është këtu, kështu që s’kam çka i përgjigjem. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit! Xhylferia e ka kërkuë fjalën.

Xhylferie Bahtijari Beqiri: Përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë që sot jeni në këtë sallë, përshëndetje edhe për qytetarët që po na ndjekin nëpërmjet rrjeteve sociale! Erdhëm edhe në një miratim të buxhetit dhe në një votim nga ana jonë, dhe me sa po e shoh, në Listën e këtyre shpenzimeve kapitale ende nuk është projekti lidhur me Urën e Zaplluxhes. Kryetar, nëse ke mundësi, përpara opinionit dhe qytetarëve të na jepni një sqarim në lidhje me këtë projekt, përse ka stagnuar dhe ku është problemi. Ndërsa nga ana ime, me shumë këmbëngulësi dhe seriozitet, këtu si delegate e Kuvendit kërkoj në përshpejtimin e hapave të këtyre procedurave, të cilat po e pengojnë vazhdimin e këtij projekti. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, Xhylferie! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Munir Jonuzi e ka fjalën.

Munir Jonuzi: Gjatë përgatitjes së këtij sesi, jam përqendruar me kujdes në buxhet me të gjitha rekomandimet dhe me të gjitha gjërat që pasojnë këtë buxhet. Në faqen e dytë, neni 4 në gjuhën boshnjake thotë ndarjen e mjeteve nga buxheti i komunës së Dragashit, arrin në Total, pra në total 10 milionë e 878 mijë euro, pastaj pyet nëse Qeveria e Republika e Kosovës ka rritur fare buxhetin. Nëse të gjitha këto shifra janë të njëjta, atëherë ku qëndron problemi këtu. Kalojmë në pikën numër 5, në programet buxhetore dhe më pas ndryshohen kodet dhe ajo përshtypje e zyrtë tashmë po zhduket. Dua të tërheq vëmendjen e administratës, për të tërhequr vëmendjen më serioze për tekstet në gjuhët e komuniteteve joshumicë. Se gabime të mëdha si ky nuk ndodhin. Ky material duhet të ishte parë më seriozisht. Lista e investimeve kapitale dominohet me 1 pikë. Është një ujësjellës i famshëm që duhet të ndërtohet. Përfshihen 15 fshatra, nga të cilët gjashtë janë në Opoje me nëntë rezervuarë. Rapca e sipërme dhe e poshtme kanë rezervuarët e tyre, si dhe fshatrat e tjerë, Rapca dhe Kërstaci janë përfshirë në këtë skicë. Është vërtet e çuditshme që një fshat, Krstac i eperm, është përfshirë në këtë projekt. Krstec i eperm ka ujë jo vetëm për nevojat e veta, por me atë ujë për të plotësuar nevojat e fshatrave Rapcen, Krstac dhe ndoshta Dragash. Janë bërë gabime, sepse në këtë projekt janë përfshirë edhe fshatrat që kanë ujë. Presidenti i referohet qeverisë së mëparshme dhe thotë se ky është një projekt i mëparshëm... Një nga drejtorët tuaj tha se qeveria e kaluar është konsultuar me qytetarët. Mund t'ju them se po, të gjithë qytetarët ishin kundër këtij furnizimi me ujë. Kjo nuk është asgjë personale kundër qeverisë së re, kundër partisë apo të ngjashme, thjesht qytetarët as atëherë dhe as tani nuk duan të jenë pjesë e këtij projekti. Unë jam në mesin e atyre delegatëve që vitin e kaluar votova për këtë ujësjellës, i cili u votua për draftin e këtij buxheti në qershor, pse, sepse e di që ky projekt është i rëndësishëm për të gjithë komunën tonë dhe mendova se do të shohim se çfarë qytetarët. do të thoshte për të. Ju organizuat debate publike, e respektuat, lavdi për këtë. Më 22 gusht ju organizuat me të gjitha fshatrat që përfshihen në këtë ujësjellës përveç Krstacit. Nuk e di pse e futet Krstacin me Globoçicë. Në atë takim dolën përfaqësues të fshatit. Ata u zgjodhën nga vendasit. Zyra e pushtetit ekzekutiv për komunitetet, komisioni është për të verifikuar njerëzit. Besojmë se këta njerëz janë më të ftuarit. Erdhën përfaqësues të të gjitha fshatrave. Asnjë nga ata përfaqësues nuk ishte pro që fshati i tij t'i bashkohej sistemit të ujësjellësit. Përveç përfaqësuesit të Rabacit, i cili ishte pro që Rabaci të mos kishte një qëndrim të qartë. Një banor nga Vranisha ka nisur një temë të re. Si punojnë këta kontraktorë në pjesën malore të kësaj komune. Hyjnë në pronën e tij, pronë private dhe bëjnë një rrugë 6 m. Nëse është në rregull. A është në rregull që dikush të hyjë në tuajin dhe më pak dhe të sillen në një mënyrë të tillë Kapadokiane? Këto kompani sillen shumë arrogante në pjesën malore të komunës sonë. E dini se çfarë ka ndodhur në anije me atë kompaninë e Ferizajt, "janë

goranë, do të shkojmë lehtë me ta". Faleminderit juve dhe autoriteteve tuaja që erdhën në shpëtim në atë moment. Kur kam dëgjuar mendimin e qytetarëve, jam zgjedhur këtu për t'i dëgjuar ata dhe jo atë që dua. Dua, siç dëshiron çdo delegat, që çdo qytetar i kësaj komune të furnizohet me ujë. Megjithatë, kur qytetarët vijnë dhe thonë se e kemi zgjidhur atë problem. Marr shembull Rabacin, 20.000 investuar në ujësjellës, sivjet 10.000, edhe Kukuljana. Të gjitha këto fshatra tashmë në një farë mënyre i kanë zgjidhur këto probleme falë donacioneve të komunës dhe qytetarëve të tyre. Tani njerëzit vijnë dhe ju thonë se do të bëjmë hidraulik. Ne nuk duam. I bëj apel delegatëve që të mos na e imponojnë këtë furnizim me ujë. Ky është një imponim ndaj qytetarëve të Kukuljanit, Rabçës, Vranishtës, Kërstacit. Ju do të jeni përgjegjës. Fondet për Barbulën janë në rregull, megjithatë, ky fond prej 170,000 është për një rrugë alternative që mendoj se është vendimtare për të gjithë ne, jo vetëm për Restelicën por për të gjithë ne. Në përgjigjen tuaj keni thënë se shuma prej 170.000 është ndarë në fshatrat gorane dhe se 60.000 janë për lojërat e fatit në fshatin Restelicë. Aty ku është një rritje prej 60,000 E, Restelica ka vetëm 80,000 dhe + 60,000 për shkollën. Restelica nuk do një rrugë alternative, kështu që rezulton. Rezulton se Restelica bujarisht dhuron mjete për fshatrat e tjera gorane. I bëj thirrje të gjithë delegatëve që ta shtyjnë këtë pikë të rendit të ditës. Le të ulemi dhe të flasim. Çfarë do të thoshte shefi i zyrës për komunitete për modalitetet, nëse nuk duam, ne nuk jemi përfaqësues të komuniteteve joshumicë, pasi ju jeni përfaqësues i të gjithë qytetarëve të kësaj komune. Kështu që unë jam më i famshmi pas jush që diskutoj çështjen e komunitetit joshumicë. I bëj thirrje të gjithë delegatëve që të mos e mbështesin këtë buxhet apo ta shtyjnë atë, sepse ju do të jeni përgjegjës për t'i imponuar komunitetit joshumicë një projekt që ai nuk e dëshiron.

Agron Gashi: Atëherë, më lejoni të ju përshëndes të pranishëm! Përshëndetje kryetar, juve kryesues dhe të gjithë asambleistët! Unë veç pak deshta të flas rreth projektit të Ujësijellësit për 15 fshatra. Me këtë dua të them se është një projekt që, kryetari tha, ishte i mëhershëm, e kam trashëguar nga të tjerët. Por nëse llogarit me vite, janë diku afër 10-12 vite ma herët që është filluar kjo. Nga ajo kohë nuk ka pasur kundërshtime, po kemi një zvarritje të këtij projekti, tani kanë lindur edhe diskutime të ndryshme. Marrë parasysh që miliona euro janë shpenzuar deri më tash, nuk e di saktë, po miliona, 3-4 milionë euro janë shpenzuar deri më tash, dhe këtu në këtë Asamble keni edhe asambleistë të cilët kanë qenë prezent dhe nuk e kanë kundërshtuar me kohë këtë. Meqenëse kanë filluar, pra, këto investime qysh më herët dhe nuk janë kundërshtuar, tashti ky projekt nuk është fontanë dëshirash të individëve të caktuar, që thotë vazhdo apo mos vazhdo. Është një projekt shumëvjeçar dhe konsideroj që janë investuar shumë mjete, për atë arsye edhe duhet të marrë rrugëtimin e vet, deri në ditën kur do të ketë implementim. Ndërsa politikat ditore që sillen nëpër fshatra, bone e mos e bon, unë po

konsideroj se nuk janë parimore dhe nuk janë të drejta. Uroj që sa më parë të kryhet kjo dhe të gjitha këto fshatra të gëzojnë të drejtën legjitime apo të drejtën më elementare, ujësjellës e kanalizim. Kaq pata. Falemnderit!

Ventaza Esati: Kryetar, ndoshta nuk më kuptove. Rruga Lestana-Rades duhet kubëzuar. Nuk duhet hequr. Por duhet të jetë një projekt i përbashkët për të dy fshatrat. Desha të them se Lestane është e perjashtuar edhe pse kemi vetëm 20 mijë, shumë pak në krahasim me numrin e banorëve të atij fshati.

Driton Ademi: Falemnderit! Kryetar, edhe një propozim e pata. Ne e dimë që në shumicën e fshatrave ka filluar ndriçimi publik me u bojë. Ky ndriçim ka nevojë për mirëmbajtje. Mendoj që, në qetë fshatrat në të cilat ka ndriçim publik, është mirë me u heq disa mjete edhe me u qit me një projekt të ri, që me e bo mirëmbajtjen e ndriçimit publik në secilin fshat. Nëse s'mundish me e bo prej investimeve kapitale, atëherë mundim edhe prej mallrave dhe shërbimeve. Për fshatrat të cilat janë të përfshirë. Po Breznen jo, se Breznja ka dalë veç po lyp, është t'u e përmend çdo Asamble, çdo takim që jemi t'u e majt, është t'u e përmend ujin, domethënë vitet e kalime, para 10 viteve, kur e ka nis Salimi. Agroni këtu është mirë, veç që është t'u i nejt kati mirë me dalë, se është t'u i përmend dy sende, ujin prej Salimit kur ka filluar edhe është t'u e përmend fshatin Bresanë. Pse investime ka në fshatin Bresanë, domethënë nuk po di me e lyp një investim në fshatin Brezne. Po e shoh sivjet që është i kënaqur me buxhetin për fshatin Brezne edhe nuk po lypka kurgjo. Shyqyr që një herë është i kënaqur edhe s'është t'u lyp kurgjo.

Bexhet Xheladini: E tërheq propozimin të fshatit Leshtan edhe Radeshë, le të mbetet ashtu si ka qenë, edhe në Grantin e Performancës do t'i shtojmë mjetet, për arsye se nuk mjaftojnë për rregullimin e kësaj rruge. Ventaza sigurisht do ta mbajë në mend këtë edhe do të kërkojë nga kjo Asamble që të shtohen ato mjete. Unë dola këtu, para sa me e qit në votim kryesuesi buxhetin, edhe një herë më nxiti diskutimi i zv/kryesuesit, i cili do me e bo njëfarë nxitje në raport Restelicë – pjesa tjetër. Restelica i ka marrë 240 mijë euro. Ato mjete nuk kanë qenë të parapara për Restelicën, kanë qenë mjete të cilat janë alokuar shtesë, dhe unë kam menduar që ato mjete t'i shfrytëzojmë për rregullimin e rrugës e cila e anashkalon Restelicën. Mirëpo, qytetarët e Restelicës, në debat publik nuk e kanë dashtë këtë, dhe ne për rregullimin e kësaj rruge do të gjejmë rrugë të tjera. Unë kërkesën ia kam bërë KFOR-it Turk, me sa e di unë sot KFOR-i Turk ka shkue me e pa atë rrugë, me e bo trasimin. Gjithashtu, për këtë rrugë po duhen ma shumë se kaq mjete, 1 milion euro po duhen, dhe ne do të bëjmë kërkesë në Qeveri për këto mjete shtesë. Edhe diçka rreth Ujësjellësit. Vota e Munirit mu më ka obliguar vitin e kaluar që të merrem me Ujësjellësin. Edhe për fshatin e këtij që sot po thotë s'do ujë, që nuk është e vërtetë. Fshati Rapçë po lyp ujë. Por Muniri, për qëllime tjera, nuk e di pse, është

kundër ujit. Këtu ka ardhë një përfaqësuese e fshatit Mlikë, ka thonë jam kryetare, që nuk ish kryetare, ka gënjye, ka thonë Mlika s'po do ujë. Edhe në buxhetin në qershor kur e kemi miratue, projeksionin, prapë ju z.Munir keni votue për këtë Ujësjiellës. Qysh deri në qershor Rapça nuk pat ujë, e tash prej qershorit paska ujë?! Qysh, a ra shi, a erdhë ndonjë vërshim, a çka u bo nuk po e di. Nuk është mirë që delegatët të bien pre e provokimeve, se ne nuk ia imponojmë kërkuj ujin, ne do t'ua çojmë deri te rezervari, ata nëse dojnë me e shfrytëzue e shfrytëzojnë, nëse nuk dojnë me e shfrytëzue nuk e shfrytëzojnë. Ka hapësirë pastaj, me u ulë me bisedue mënyrën e pagesës, formën e pagesës, me pagesë, pa pagesë, ka forma tjera të cilat mund t'i diskutojmë. Mu vota e Munirit më ka obligue që ta shpall tenderin për Ujësjiellësin. Tenderi është shpallë, është lidhë kontrata me kontraktuesin, na kemi obligim ligjor që këto mjete, e bëmë s'e bëmë Ujësjiellësin, këto mjete, nëse ne tërhiqemi, ato mjete punëkryesit duhet me ia pague. Këtë edhe Muniri e di që është kështu, po pse po vepron qeshtu nuk po e di. Falemnderit!

Uran Halimi: Falemnderit, kryetar! Një minutë replikë e ka lyp Munir Jonuzi.

Munir Jonuzi: Më vjen mirë nëse vota ime ju detyroi të merreni më seriozisht me çështjen e furnizimit me ujë. Tani le të votojmë kundër detyrimit për t'u marrë me kërkesat lokale. Ju thatë se përfaqësuesja e Mlikës nuk është përfaqësuese, unë jam në komision dhe e di që është. Me sa duket nuk me kuptove. Rapça nuk ka pasur ujë, kemi pasur projekt, kemi punuar, shpresoj që projekti të përfundojë këtë vit. Unë nuk merrem me asnjë manipulim të opinionit publik. Unë dua t'i përfaqësoj qytetarët vetëm ashtu siç e meritojnë. Nëse thonë, mos e bëj këtë, pse ta bëj unë. Unë jam zgjedhur këtu sepse më kanë zgjedhur qytetarët që t'i përfaqësoj. Dhe secili prej jush. Nuk dua që kjo të kthehet në një polemikë mes nesh. Ky është qëndrimi i 10 viteve më parë. Unë nuk jam kundër projektit, jam kundër detyrimit të qytetarëve për të hyrë në këtë sistem.

Uran Halimi: Falemnderit, z.Jonuzi! Unë po besoj që u shterr debati në lidhje me këtë pikë. E kemi tash me e hedhë në votim. E kemi domethënë miratimin e Buxhetit me propozime, me ndryshime, ashtu qysh i keni kërkue ju delegatë, në fakt ne, edhe e kemi miratimin pa ndryshime. Së pari na duhet me e hedhë në votim propozimin, domethënë a kemi me miratue me ndryshime... domethënë veç kemi me qit një herë në votim edhe kuptohet, është miratimi i Buxhetit me kërkesat ose me propozimet, domethënë më ndryshime. Në rregull, atëherë kush është pro kësaj pike të rendit të ditës, duke përfshirë edhe ndryshimet që i kemi kërkue nga ekzekutivi? Kush është kundër kësaj pike të rendit të ditës? Abstenim? I kemi 17 vota pro, 2 kundër dhe 4 abstenime, kalon edhe Buxheti për vitin 2024, duke përfshirë edhe ndryshimet. E kemi pikën eventuale, vazhdojmë në ora 14:00, mas pauzës.

Atëherë, të nderum delegatë, mirë se u rikthyem për me vazhdu seancën aty ku e lamë! Tash e kemi pikën e fundit, është pika e nëntë. Përpara se me shkue te qekjo pika e nëntë, ky këshilltari ligjor po thotë që i kemi nja dy kërkesa. T'i shqyrtojmë qato edhe pastaj po vazhdojmë me eventualen. Njëra kërkesë po thotë, nëse keni durim unë e kisha lexue. Është kompania Galaxy që ka kërkuar për me i dhonë hapësirë edhe vend për me vendos panele solare. Na e kemi diskutue këtë në Komitet edhe s'kemi pas të drejtë me vendos, sepse ai vend të cilin e ka kërkuar ky zotëriu, ka qenë në kontest gjyqësor. Po besoj që vazhdon me qenë në kontest gjyqësor. Qetash po do me pru kundërshtimin e vendimit të Drejtorisë. Pse me e pru në Kuvend, kur ai mundën me pas instanca të tjera gjyqësore, ose ka rrugë krejt tjera prej Kuvendit. I bjer që me këtë kundërshtim na veç informohna që po e kundërshton edhe në rregull, kundërshtoje i nderum zotni, po na s'jemi kompetentë për me rikthye kundërshtimin e tij në rishqyrtim. S'është punë e jona kjo. Edhe e kemi një kërkesë tjetër, po thotë 'Kërkesë për dhënie të pëlqimit për ndërtimin e parkut energjetik diellor', prapë është e të njëjtës natyrë. Është kompania PUNA Sh.P.K. në Brrut të Dragashit:

Duke u bazuar në Planin Zhvillimor për Energji të Ripërtëritshme të Republikës së Kosovës dhe Planin Zhvillimor për Energji të Ripërtëritshme të Komunës së Dragashit, kërkojmë nga Kuvendi Komunal që të na japë pëlqimin për ndërtimin e parkut energjetik ...

Pëlqimin prapë se prapë, edhe ky zotëriu paraprak, duhet me shkue me e lyp në Drejtorinë përkatëse, jo në Kuvend. Këshilltari jem po thotë që këtë kërkesë e kemi çue edhe te Drejtoria përkatëse edhe presim prej Drejtorisë me ia dhënë një përgjigje atij. Por nëse është diçka që duhet me ardhë në Kuvend, besoj që drejtori mundën me na pru, e sjell në Kuvend edhe mundim me e shqyrtue nëse është diçka e natyrës sonë. Përveç këtyre dy kërkesave, në KPF kemi pas edhe disa kërkesa për shëndetësi edhe diçka të ngjashme, të cilat ia kemi adresue kryetarit të Komunës dhe në KPF. Po vazhdojmë atëherë në pikën e fundit, është pika eventuale edhe kemi rastin me diskutue për tema të ndryshme. Ju ftoj që ta merrni fjalën secili që ka ndonjë shqetësim për ta ngritur në lidhje me ekzekutivin apo të çfarëdo natyre tjetër. Kush do me e marrë fjalën? E kemi nënkryetarin prezent. Po, ma kujtuan që duhet me e dhënë edhe një sqarim në lidhje me atë punën e Komisionit, të cilën çëshjte e ngriti z.Ademi para se me e votue rendin e ditës. Na kemi thënë që në seancën e shtatorit duhet me raportue, në takimin e fundit që e ka mbajt Komisioni, në seancën e shtatorit kemi thënë edhe kjo është e dokumentume. Të ftoj në seancën tjetër me ma gjet ku kam thënë në seancën e gushtit edhe me ma sjellë si dëshmi. Sidoqoftë, në gusht na s'mbajmë seancë, e kam ditë atë prej kohësh. Komisioni ka vendos, edhe një herë ka bo kërkesë te Zyra e Personelit, aty ku miratohen

pagat, ose në njëfarë mënyre sillen pagat, kemi kërkuar që me na sjellë listën nga janari i vitit 2021 deri në fund. Po, nga fillimi i mandatit si delegatë, prej kur e kemi dhënë betimin atëherë, diku kah dhjetori, e deri në fund, ka me na pru listat e pagave. E kemi urdhëruar Zyrën e Kuvendit që me i dorëzue listat e pjesëmarrësve, nënshkrimet konkretisht, edhe në një takim të fundit unë po besoj, kanë me u ballafaquar faktet edhe kemi me dalë me një konkluzion se çka është gjetur, çka është e papërputhshme mes nënshkrimeve dhe pagave. Domethënë, gjithkujt që iu bë padrejtësi, kemi me u mundue që në mënyrë retroaktive me iu kompenzue ato mangësitë. Po edhe ata që kanë përfitue, nëse ekziston dikush, ka me i qit edhe me u raportue përpara Kuvendit nga kryetari i Komisionit. Ky ishte njoftimi për Komisionin në lidhje me pagat. E kemi pikën eventuale, fjalën po e kërkon z.Samidin Xheladini.

Samidin Xheladini: Të nderuar delegatë! Ndoshta është pak banale me folë. Komuna ka organizue një vizitë studimore, ose nuk e di qysh e ka titullue, me shkue në Vlorë. Unë kam folë me nënkryetarin, kam folë me Suadin, kam folë me Ademin edhe me disa tjerë. Edhe në fund, këta kanë shkue edhe mu s'më kanë marrë, me arsyetimin se na Kuvendi s'kemi të drejtë. Ngonë çfarë rasti është, që na delegatët e Kuvendit, krejt kanë të drejtë, na s'kemi të drejtë. Aryetimi u konë qeky edhe prezent u konë edhe Urani. Hajt tash, çfarë përgjigje mundem me ju dhënë unë. Jo, kërkuar s'është lajmëruar prej Kuvendit, veç unë jam lajmëruar. Edhe s'na kanë thirrë hiç, po unë kam marrë vesh edhe jam lajmëruar, plus edhe një vend shtesë i kam thënë, edhe një shok me e pas, dy veta. As s'na kanë njoftue, po ma e keqja që na jemi konë në Turqi, anëtarët edhe stafi i Kuvendit u konë në Turqi. Stafi i Kuvendit shkon, jo Administrata, këso gjona mos të bëhen, këso gabime, se këtu s'është pronë e jemja Komuna, as e Ademit, as e Urani, po as e nënkryetarit. Kryetari s'ka nevojë me e ditë, kryetari besoj që s'ka gisht në këtë punë edhe ishalla s'ka gisht. Në qoftë se ka gisht, mban përgjegjësi ai. Kur jam lajmëruar për me shkue në vizitë studimore, Ademi, edhe krejt i kam thirrë, jam lajmëruar me kohë një javë përpara, më kanë thonë s'kie të drejtë me shkue.

Uran Halimi: I nderum delegat, ke të drejtë m'u ankue, se na kemi bo përjashtime edhe i kemi marrë edhe këta që janë jashtë Kuvendit. Kështu që, herën tjetër kur të shkojmë në vizitë studimore, s'i marrim mo. Ta lëmë këtë pjesën, po vazhdojmë, mundemi me e diskutue edhe këtë, në fund kryetari e jep një përgjigje besoj.

Bexhet Xheladini: Xhyllferie, atë pyetjen që ma bëre për Urën e Zaplluxhes, kërkoj falje që kam harrue me të dhënë përgjigje. Te Ura e Zaplluxhes nuk janë problem mjetet, nuk është problem pronësia, prona, pronari. Nuk ka pengesa në këtë drejtim. Është problem kualiteti i punimeve dhe unë kam qenë për këtë çështje në ministri, jam takuar me personat përgjegjës dhe përgjigja e tyre ka

qenë që jemi duke e analizue edhe do të vendosim çka do të bëjmë me urën, do ta prishim krejt apo do ta bëjmë një formë tjetër. Kështu që, ata më kanë thënë që ura ka me u ndreq pa problem. Vetë, deshta ta njoftoj opinionin se mund të ketë edhe thashëethëme, jo pronari s'po lë, jo s'ka mjete. Të gjitha janë, përveç kualiteti të punimeve që kanë qenë të dobëta. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Jetmir Ajdini, pas tij z.Nedžmidin Sejdilar. Ju lutem, dhjetë minuta kohë i keni për fjalën, nga një minutë replikë edhe ma shumë s'e zgjasim.

Jetmir Ajdini: Përshëndetje edhe një herë! Po e ngris një shqetësim të banorëve të fshatit Zgatar, në lidhje me transportin e nxënësve që organizon Komuna nga fshati Zgatar në fshatin Blaç. Transporti organizohet vetëm nga pjesa e fushës, pjesa nalt e fshatit është e diskriminime nga ai transport. Banorët e fshatit Zgatar e kanë ngrit këtë kërkesë edhe te kryetari, edhe te drejtorët, nuk është kthye ndonjë përgjigje. Transporti vazhdon me u bo në të njëjtën mënyrë prapë. Nxënësat që vijnë prej pjesë nalt të fshatit detyrohen të udhëtojnë rreth 1 km e ma shumë në këmbë për me ardhë deri te transporti. Ju kisha lut që, nëse në kontratë nuk është e specifikume, me e plotësue edhe këtë, edhe këta fëmijë me shkue me u marrë në pjesën nalt të fshatit për me u transportue në shkollë. Ky ishte një shqetësim i asaj pjese të banorëve, që fëmijët e tyre nuk gëzojnë transport. Pyetja tjetër është në lidhje me shumën e mjeteve që i keni ndarë për investim në pompat e fshatit Zgatar. Është një shumë e mjeteve që e kemi ndarë në miratimin e Buxhetit të vitit të kalum. Nuk është investue hala kurgjo në atë pjesë të pompave. Kisha pas qef me e ditë a keni çelë ndonjë tender edhe kur do të intervenohet në atë pjesë, kur ato mjete do të harxhohen për rregullimin e atij problemi në pjesën e pompave që është. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Kryetar, më lejoni t'ju informoj se Çagllavica është afër Prishtinës në Kosovë, dhe herën tjetër kur të vini të thoni se jam mysafir në mediat serbe, duhet ta dini se Çagllavica është në Kosovë. Nëse ia keni dhënë dikujt tjetër, atëherë ju e merrni atë përgjegjësi. Daljet e të ftuarve janë publike dhe unë qëndroj pas çdo fjale të thënë në atë emision. Në atë shtëpi mediatike kanë qenë mysafirë shumë personalitete eminente të Kosovës, pothuajse të gjithë kryeministra, njerëz të njohur e të ngjashëm. Nuk duhet ta shprehësh atë sasi xhelozie në këtë mënyrë. E kuptoj që jeni në një lidhje mediatike dhe duhet të rrini me Uzejrin, do të kishit bërë një foto me një nga zëvendësministrat. Unë shoh që nuk keni foto të reja. Qendra mediatike Çagllavica nuk është media serbe, por media e Kosovës. Kështu është në statut, financohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe mendoj se për këtë duhet të përgjigjeni para qytetarëve. Fakti që emisionet janë në serbisht, çfarë të bëj, njerëzit më thërrasin edhe në anglisht. Kam emisione edhe në mediat shqiptare. Më gjetën mua, siç e gjetën

Ramush Haradinajn, Hashim Thaçin, Hotin, Kurtin, edhe mua më arritën, çfarë të bëj me ju që nuk ju arritën. Për etiketimin dhe lidhjen time me strukturat serbe, zoti Kryetar, në kabinetin tuaj keni kontabilistë nga strukturat serbe. Me kë keni bërë koalicion?, ejani dhe na tregoni këtu se cilat ishin kushtet që ju dha Adem Hoxha. Pse i justifikoni rregullisht Adam Hoxhës se si e mbroni sistemin e tij. A mendoni se ai është këtu me ju në një koalicion për shkak të një drejtori. Erdjan Ljimance nuk ka ku të gjejë vend. Kur flasim në mënyrë konstruktive, flisni sinqerisht, drejtë dhe sinqerisht dhe mos më lidhni me ato gjëra. Nuk do të ishte e dobishme nëse do të kisha lidhje të mira me Beogradin, sepse menjëherë do t'ju kisha dy këshilltarë në opozitë. Të nderuar qytetarë, sot votuam buxhetin, kërkuam nga pushteti ekzekutiv që të respektojë vullnetin e qytetarëve që të mos vendoset ujësjellësi qendror në Gorë, herën tjetër që të keni probleme me ujësjellësin qendror kontaktoni Miralm Rahte, Merhnisa Brenola, Ventazi Esati dhe Edin Kurt, ata e mbështetën këtë projekt jo ne.

Shpetim Hajredini: Përshëndetje edhe një herë për të gjithë! I nderuar kryetar, kam nja dy pyetje, eventualisht tri, që kanë të bëjnë me fshatin Kuk. Pyetja e parë, besoj që ke qenë, ke bo foto në rrugën e cila është asfaltue për bjeshkë. Deshta të di nëse e ke shikuar kualitetin e punimeve. Në vitin e kaluar personalisht kam qenë shumë i kënaqur me trashësinë dhe kualitetin e punimeve që janë kryer, ndërsa këtë vit është shumë i dobët. Edhe me sa mora informata, por realisht e kam ditë edhe më herët, që shtresa e dytë e asfaltimit nuk kryhet në këtë trase. Me këtë shtresë, me këtë kualitet, po shpresojmë të kalojë një vit, dy, por nuk besoj. Nëse vetëm kanë fillue punimet, nëse shkojnë mjete të rënda, atëherë ky asfalt nuk i përballon. Jam i bindur dhe këto para të qytetarëve, ky investim ka me shkue huq. Tjetra ka të bëjë gjithashtu edhe me rrugën tjetër që ka qenë trivjeçare, por ajo ka qenë kubëzim, rruga Kuk-Kosavë. Tani kanë filluar punimet në atë rrugë, po shpresoj që të përfundojnë si është më së miri, por unë deshta ta bëjë një kërkesë. Nëse kie mundësi me diskutue me pronarin - jam i detyruar prej disa pronarëve të tokave që t'jua bëj këtë kërkesë – që, e dish, po e them në gjuhën fshatarski, vijat të cilat janë në anën e rrugës janë zënë prapë. Ato i kanë hapë para dy viteve, tash janë zënë prapë edhe kishin fillue me dalë nëpër prona me dëmtue. Nëse ka mundësi, ai punëkryesi besoj që për gjys orë e kryen atë punë, i hap edhe një herë prej fillimit. I bjer diku nja 150-200 metër po më duket, ma shumë aty nuk ka nevojë. Por nëse nuk shpreh gatishmëri që ta kryejë ai përmes këtij projekti, le të tregojë realisht sa kërkon, një shumë unë do ta tuboj edhe vetëm mos t'i dëmtojë pronat. Pyetja e tretë faktikisht nuk ka të bëjë me ty, ka të bëjë drejtorin e Administratës. Më ka premtue që do të ma sjellë kontratën e punimeve, e di, 2500 eurshin. Atë nuk e kam pa, nëse kie mundësi due me e pa, me ma sjellë. Jo jo, unë jam konë, se unë s'lëshoj pe. Mu më ke këtu prej fillimit deri në fund. Po s'ka rëndësi, kryesore nëse ke mundësi sot ma bjer kontratën, veç po kam

dëshirë ta shoh. Po po, origjinali më duhet edhe mu, veç me ma sjellë me e pa a u krye, çka ka ndodhë me to edhe jemi të pastër. Ju falemnderit!

Uran Halimi: Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? I kam unë në fakt nja dy pyetje. Deshta me u ndërlidhë prapë te ajo çështja e atyre kaptazhave që folëm pak më herët. Me një kontratë të mëhershme, unë e kam pa që kaptazhat janë rregullue në fshatin Blaç, është pranue puna, janë konë në projekt të atij ujësjellësi që dilke prej bjeshkës në Shtavë. Njëri prej atyre kaptazhave, se janë konë tre në kërkesë për me u rregullue, njërin prej tyre e kanë lye me njëfarë zifti përjashta, atë e kam pa. Dera është e vjetër, e pandërrume nëse e merrni që është ndërhy. Ndërsa, tek dy kaptazhet tjera është fare pa intervenu. Uji është jashtë kaptazhave, munda me ju gjet edhe dëshmi nëse keni dëshirë, edhe kontratën ku është pranue puna si e kryer, e kam edhe atë. Deshta me m'u përgjigj mu edhe qytetarëve që presin besoj përgjigje, qysh kemi mundësi qetash prapë me ndërhy te puna e kaptazhave që vjet është krye ajo punë. Paret janë ndarë prapë, për një për një punë që është krye, e realisht nuk është krye kurgjo. Ato dyert e vjetra janë të shpume me plumba aty, gjuetarët a s'e di kush e ka bo atë. Na pijmë ujë me ato dyer të shpume, me atë ujin që del jashtë kaptazhave, besoj që futet prapë në ato kaptazhat e ujësjellësit. Bile kryetar, të pata thonë ma herët që janë t'u ta pi duhanin tinëza, e pate marrë goxha ngat zemrës. Kemi nis me ia pa edhe tymin kohën e fundit. Tjetra çështje ka të bëjë me do emra që patëm folë në seancën e fundit. Drejtori m'i solli do emra, po jo ata që unë i kërkoja. Drejtor, i kam sigurue edhe ata emra tjerë që ti s'm'i ke pru seancën e fundit. Është mirë me i bo publike ti ata, bile del reago edhe në faqe të Komunës për këta emra që ka kërkuë Urani. Më ke thonë që janë aktivistë, ose s'janë aktivistë tonit. E kam listën edhe të aktivistëve të juaj, të shoferave të traktorëve që s'dinë edhe m'i kallë traktorat, e lë mo m'i vozit. Kështu që, që duesh, ta sjelli listën. Po po qetash. Adem, të lutem, te Mentori unë po e dërgoj një listë, veç shko m'i merr kopjet, të ia japim secilit prej delegatëve. Falemnderit! Vetëm këtë deshta me e diskutue, mundësisht përgjigjen e kaptazhave ish konë mirë me ma dhonë. Dikush tjetër a do me e marrë fjalën, përpara se me dalë kryetari ose dikush nga ekzekutivi me i dhonë përgjigjet? Mundish kryetar, ose kushdoqoftë.

Bexhet Xheladini: Për Samidinin çka ka diskutue s'po e di, kështu që s'kam mundësi me i dhonë përgjigje. Sa u përket pyetjeve të doktorit, kolegës tem, për fshatin Zgatar, unë e di që dy problemet ma kryesore të fshatit Zgatar janë uji, masnej vjen edhe transporti i nxënësave. Edhe doktor, pa ndihmën tënde, këto dyja i kam krye. Edhe ujin e votuam pa ndihmën tënde, po edhe transportin e nxënësave prej aty ku ke kërkuë e kemi krye. Sa i përket pjesëmarrjes së z.Nedžmidin Sejdilar në studio në Çagllavicë, unë nuk e kam gjykue aktin pse ke marrë pjesë ti aty, unë kam thënë ke shkue me bo propagandë. Jo pse ke marrë pjesë, ti mundish me shkue ku të duash me folë. Sa i pëket

pyetjes së Shpetim Hajredinit për kualitetin e asfaltit, ende nuk e di, unë kam qenë e kam pa, por ende nuk e di sa është trashësia dhe kualiteti, por e kam caktue edhe Kapllanin edhe nënkryetarin me i përcjellë punimet. Sigurisht që do të bëhet shpuarja dhe marrja e mostrave dhe do të matet. Sa i përket shtresës së dytë, e keni humb ju shtresën e dytë, i keni humb paret, tash na kanë mbet pare veç për shtresën e parë. Edhe na shtresën e parë do ta kryejmë. Kubëzimi Kuk-Kosavë ka me përfundue, qato punimet shtesë që nise me thonë, sigurisht këtu nënkryetari e dëgjoji kërkesën tënde, edhe Kapllani. Ato janë pak punë, nëse ai s'don me i krye kështu, ka metoda tjera që i kryejmë. Më doket doktori e ka bo edhe një pyetje për pompat. Projekti është në ritenderim, çështja e pompave të ujit do të kryhet këtë vit. Uran, sa i përket kaptazhave që janë krye ose s'janë krye, është mirë, si Kuvend, formojeni një komision, le të shkojnë në vend të ngjarjes, le ta kontrollojnë gjendjen, vijnë në financa e kqyrin çka u pague e çka s'u pague. Unë jam për transparencë edhe me e pa çka u bo e çka s'u bo. Unë s'muj me thonë që u bo, se nuk e di, por as s'muj me thonë që s'u bo.

Uran Halimi: E kie kontratën që është nënshkrue, është pague edhe që është bo. Kushtet edhe kriteret e asaj kontratës i ke aty. Sa i përket kësaj që a u bo, i ke letrat. Sa i përket asaj që u bo ose s'u bo në terren, unë t'i sjelli dëshmitë, s'kemi nevojë për komision, unë ta bëj komisionin vetë, personalisht.

Bexhet Xheladini: Kuvendi është më mirë me bo, ma zyrtare, jo ti. Unë nuk po them që ti ato që po i thuash janë ose nuk janë të vërteta, unë po them që kam dëshirë me e vërtetue.

Uran Halimi: Faleminderit! E ka lyp një minutë replikë z.Ajdini.

Jetmir Ajdini: Përshëndetje edhe një herë! Kryetar, transporti i nxënësve, unë thash, po fillon prej fushës, nuk po bëhet transporti me e përfshi edhe pjesën nalt të fshatit. Që i bjer, ma shumë se 1 kilometër udhëtojnë në këmbë ata nxënës për me ardhë te kombi në fushë. Unë lypa sqarim edhe mundësi me e pa qat kontratë, qysh është nënshkrue edhe çka përfshin ajo kontratë. Unë besoj se edhe ata nxënës që duhet me udhëtue 1 kilometër e diçka në këmbë, edhe ata duhet me qenë pjesë e transportit, me shkue kombi ose diçka m'i marrë prej pjesës nalt të fshatit edhe me vazhduë transporti për shkollë. Ti po thuesh është bo, unë po të them s'është bo, se është shqetësim i banorëve që ta kanë ngrit edhe ty personalisht shumë banorë të qasaj pjese nalt të fshatit, edhe një pjese të drejtorave tu. Falemnderit!

Bexhet Xheladini: Kontrata është e nënshkrue Zgatar-Blaç. Edhe tenderi është qashtu. Po unë të thashë, nga vullneti i mirë i imi, e kam lut fituesin e tenderit që ta bëjë transportin nga varrezat në Zgatarin e vogël, kah Brruti. Edhe prej ditës së hënë, transporti fillon, vetëm dimrit nuk ka me funksionue. Te na ka mungue përvoja në këtë drejtim dhe na e kemi shkruë tenderin Zgatar-Blaç.

Vitin e ardhshëm, kur ta bëjmë tenderin, e shkrujmë ‘prej varrezave...’. Mirëpo, tenderisti që e ka marrë tenderin, ka pranue me i bart gjatë kohës kur është verë edhe nuk ka ngrica. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit! E ka lyp një minutë replikë z.Sejdilar. Ndërkohë, Sadami do t’ua shpërndajë listën që e ka bo kopje. Mundish me ua dhënë secilit delegat. Sa për informacion, kjo është ajo lista të cilën unë ia kërkojsha drejtorit të Administratës, se thojke po të vjen inati që janë hek disa traktoristë më herët. Unë e disha ata që janë largue, po s’kisha të bëjë me ta personalisht absolut. Këtë listën, i nderum drejtor, e kam kërkuar atë ditë, se ti ma bijshe një tjetër. Është fjala për këtë listë, e kam marrë në uebfaqe të Komunës unë. Po de, publike u konë, s’ka kurgjo jopublike. E, ky drejtori në atë rast u arsyetojke që këta janë të njëjtit shofera të kalum. Vazhdo, Sejdilar!

Nedžmidin Sejdilar: Një gjë që më shqetëson është më e rëndësishme se Çagllavice, ajo është Qendra Shëndetësore në Dragash. Në seancën e fundit ju vetë thatë se ministria mbylli dy laboratorë tuaj. Sa i përket atyre laboratorëve, më intereson si është situata. Gjithashtu kam vërejtur se kemi kaos në qendrën shëndetësore sepse qendra shëndetësore është duke u rinovuar, ndaj dua të di se deri ku kanë arritur punimet. Kam pasur dy raste gjatë verës kur kam kërkuar nga stafi mjekësor që të intervenojnë në terren, nuk kanë mundur sepse një shofer me teknik ishte tashmë në Prizren dhe nuk kishin njeri në dispozicion këtu. Unë i kuptoj këta njerëz të mrekullueshëm dhe nuk jam aspak i inatosur me ta. Më intereson nëse automjetet mjekësore të Shtëpisë së Shëndetësisë në Dragash kanë leje për të intervenuar në terren. Nëse një qytetar i një fshati ka nevojë për një shërbim të tillë, a mund të shkojë një ambulancë në terren apo njerëzit duhet t’i sjellin vetë të sëmurët në qendrën shëndetësore. E them këtë sepse një grua kishte nevojë për këtë shërbim, kur kërkoja këtë lloj shërbimi më thanë dhe gjithçka që mora ishte një barelë dhe një karrocë. Keni edhe një ambulancë që shoferët ankohen se nuk mund të ecë më shpejt se 40 km në orë dhe automjeti është prodhuar në vitin 2021. Unë jam i interesuar, por edhe qytetarët e komunës sonë, për numrin e Shtëpisë Shëndetësore në Dragash. Tani, nëse dikush sëmurët në korridor, në cilin numër do të telefononi?

Uran Halimi: Faleminderit, z.Sejdilar! Fjalën e ka kërkuar znj. Qafleshi Skeraj.

Arijeta Qafleshi Skeraj: Përshëndetje kryetar, përshëndetje kryesues, përshëndetje për të gjithë! Unë e dini që jam asambleiste edhe jam në pozitë, po me këta emrat jam seriozisht shumë e shqetësuar. Unë nuk e di a ka kandidatë dikush prej fshatit Rrenc. Asnjë. Po i shoh që me disa fshatra janë ka dy. Unë dua prej kryetarit këtu një pyetje. A ka kandidatë dikush prej fshatit Rrenc ose Bellobrad, se prej atje edhe vij, edhe pse këto neve nuk na vijnë kurrë në Kuvend?

Uran Halimi: Varet prej kritereve, Arijetë. Ka me na dhënë përgjigjen tash drejtori, po besoj. Dikush

tjetër a do me e marrë fjalën? Driton Ademi e ka kërkuar fjalën.

Driton Ademi: Falemnderit, kryesues! Deshta me diskutue për qeta emrat. Me sa po i shoh, qeta emra qetu janë mbi 80% anëtarë të LDK-së. Pjesa dërmuese e tyre – nuk është për çudi, se i ka marrë të vetit – veç një paska mbet i vitit të kaluar, që u konë i joni, me sa e pashë unë. Më e keqja që është, edhe që s’un janë punësue në mënyra të tjera, po shoh edhe ish-kandidat për Asamble që janë këtu. Unë këta traktorista, përveç nja dy-tre vetë që i kam pa t’u u sjellë, asnjë s’e kam pa. Ka në listë, veç nuk po due me ia përmend emrin, për hatër të shumë sendeve, ka hi qetu në listë të qesaj pagave edhe nuk e kam pa kurrë me traktor. Traktorit s’e di, kerrit po, e di që di me i grah.

Uran Halimi: Sa për sqarim, këta emrat që ka thënë – mu më interesojke, se drejtori thojke nuk janë aktivistë politikë tonit. Unë veç për qato e kam ngrit këtë çështjen, se thojke nuk janë njerëzit tonë. Aty i njohim na.

Driton Ademi: Prej qetyne emrave, unë shumicën e tyre nuk i kam pa me traktora t’u pastrue borën. Nashta, veç si t’i kanë pastrue prej krypës traktorat nëpër garazha, se ndryshe, me dalë në terren qetu, vallahe nja shtatë vetë nuk kanë dalë hiç. Veç kanë marrë pare, se neve na kanë akuzue t’u nejt që kanë marrë pare, i kemi pague. Po unë qetu po i shoh që shumica e tyre ma shumë kanë nejt sesa që kanë punue.

Uran Halimi: Falemnderit, Driton! Kryetar, Arijeta ta ka bo ty pyetjen për këta traktoristat, tha përgjigje prej tjetërkujt s’due.

Bexhet Xheladini: Seriozisht nuk e di kush ka konkurue. Por është drejtori i Administratës që e di edhe ai ka me iu përgjigj edhe pyetjeve të tjera.

Vetim Ramadani: I nderum kryesues, zv/kryesues, kryetar i Komunës, të nderum asambleistë! Pikë së pari, kjo listë që është publikue, duhet me e ditë një diçka. Këta nuk janë punëtorë të Komunës, për dallim prej atyre që na i kemi ndalë. Këta janë punëtorë, rekrutimin e të cilëve e ka zhvillue një organizatë joqeveritare, përmes thirrjes publike. Nëse ekziston një dokument që këta persona kanë marrë pagë apo kanë kontratë me Komunën e Dragashit, atëherë personat që i kanë bo këto veprime duhet me shkue në përgjegjësi. Procedura e konkurrimit të tyre ka qenë online, përmes uebfaqes. Thirrjen që e ka marrë – merrne kontratën, bëni kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, kqyrni të gjithë procedurat e rekrutimit – nuk janë këta të rekrutuar nga ana jonë. Nga ana jonë, ky është një vendim për furnizim me naftë. Dhe lapsusi tjetër, kryesues, është këtu: prej kur Komuna paska nis me iu dhënë autorizim për naftë punëtorëve të vet? Punëtorët e Komunës nuk marrin autorizim për naftë. Kjo është listë që i ka autorizue, sepse këta nuk janë punëtorët tanë. Kryetari i Komunës ka marrë

vendim që me iu lejue me marrë naftë. Ne kemi zyrtarë, këtu janë të pranishëm, edhe në sallë, edhe në sallë të përkthimit, le të tregojë dikush ndonjëherë që ka pas ndonjë procedurë me marrë vendim kryetari për me i dhënë naftë, furnizim të veturës. Nuk jepet, sepse është punëtor i yni. Këta persona janë të rekrutuar përmes procedurave të organizatës që e ka fitue thirrjen publike. Dhe për këto, bëni kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, le t'i zhvillojnë ata, ju hetoni, nëse ka material për prokurori, përtej prokurorinë i çojmë. Ju kërkoj falje paraprakisht, se po jua marr edhe kohën ndoshta më tepër edhe jemi në fund të seancës. PDK – Dega në Dragash ka bo një reagim, ku e ndiej obligative edhe si prind, edhe si familjar, me e dhënë një sqarim për opinionin publik. Është e treta herë që mu si person më përmenden njerëzit e familjes, përmes postimeve të subjektit të apostrofuat. Dhe tash kanë filluar ta ndërrojnë zhargonin, nga 'vjehera' në 'nëna e gruas', dëshirojnë të tregojnë afinitetin apo nuk e di se çka. Statusi i fundit ka qenë sulm direkt ndaj meje, me pretendimin se unë kam marrë kompetenca të X apo filan drejtorie, apo filan drejtori. Dua ta bëj të ditur për opinionin publik, se unë Vetim Ramadani, ushtroj detyrën e drejtorit të Administratës dhe asnjë detyrë tjetër në Kuvendin Komunal të Dragashit. Po flas më ngadalë, në mënyrë që përkthimi të jetë simultan në të njëjtën kohë. Unë si drejtor jam menaxher i kontratave të furnizimit me materiale administrative për tërë organizatën buxhetore. Pretendimi se unë paska marrë kompetenca të DKA-së nuk qëndron. Unë jam pikërisht në kompetencat e mia. Ajo e cila fshihet mbrapa atij postimi është diçka tjetër. Sepse, në momentin që Vetim Ramadani është drejtor i Administratës dhe menaxher i kontratave të furnizimit, në Komunën e Dragashit nuk mund të blihen për një muaj 1695 bateri 1 volt e gjys, që në distancë bëjnë 170 metër. Me bateri 1 volt e gjys e lidhim DKA-në me Komunën. Për një muaj, një superdrejtor i juaji – për korrektësi kam edhe faturën ...

Uran Halimi: Ti veç e ke për obligim me iu përgjigj pyetjeve të asambleistëve. E ke shumë gabim, nëse dalish prej kontekstit me reagime, mundesh me reagime...

Vetim Ramadani: Pyetjeve të Dritonit jam duke iu përgjigj. Ai mu më tha që paska ma keq se na që jemi konë. A është ky pretendimi?

Uran Halimi: Drejtor, ti nuk ke të drejtë me hy në çështje politike. Nëse ta ka cenu integritetin, padite, s'është problem ajo. Ti veç ke të drejtë me iu përgjigj pyetjeve që t'i bëjnë asambleistët. Edhe kryetari këtë ta dëshmon, që s'ke të drejtë me hy në atë aspekt.

Vetim Ramadani: Jo, s'diskutohet ajo punë, po është pika eventuale. Unë reagoja si pasojë e një postimi që është bë në vazhdimësi për me ma cenue të drejtën time. Pyetjeve të asambleistëve të gjitave me rend do të mundohem me iu përgjigj. Tash, po hy vetëm pak edhe thashë nuk due me e zgjat më tepër, po veç me kallxue që në Komunën tonë nuk blihen kofera, as vazhduesa të rrymës ka

120 euro. Këtë mbaje në mend, për këtë, këto sende janë ndalë. A këtë që po e ngresh dorën ti, ta shpjegova, nëse e gjen një vendim që qata persona kanë marrë paga qysh kanë marrë ata të juajit, e qysh ke marrë ti, prej Kuvendit Komunal të Dragashit, çoni lëndët në prokurori, le të merret prokuroria o burrë. Na gjykatë s'jemi. Falemnderit!

Uran Halimi: Falemnderit, drejtor! Unë e kam edhe një pyetje. Na thaje që këtë shoferë janë rekrutue prej një OJQ-së. Qato deshta me të ndërhy, me ta pyet emrin, po me siguri është ajo OJQ-ja Human Care, që e keni shpërblye me 186 mijë euro kontratë, organizatë kjo e cila, po të hysh në Google me lexue, e shohish që është organizatë që ka të kaluar jo të mirë, duke u nisur prej Komunës së Mamushës, te ajo e Prishtinës, e së fundmi te kjo e Dragashit. Më e keqja e krejt këtyre të këqijave është, përveç që keni rekrutue në to njerëz të juajit, më e keqja është që ju, përveç që ia keni dhonë 186 mijë euro, ju po ia paguani edhe naftën, domethënë po ia trashni edhe ma shumë qafën. Jo, s'është shpifje, ti e ke kontratën publike, 186 mijë euro ia ke dhonë. Okej, po a thaje kanë të drejtë me marrë naftë këta? Këta shoferat e traktorëve a tha kanë të drejtë me marrë naftë? Marrin naftë edhe e pastrojnë borën? Në emër të kujt? Kush i ka rekrutue? Po pse atëherë OJQ-ja i ka marrë 186 mijë euro? Sidoqoftë, mundish me dalë me ma dhënë edhe këtë përgjigje, nëse e sheh të arsyeshme, por kjo është e vërteta. E dinë edhe qytetarët, se i kanë pa ata shofera, edhe qysh tha parafolësi im, janë nja dy a tre veç që i kemi pa me traktora, se do tjerë s'dinë edhe me i grah. Sidoqoftë, po e vazhdojmë na. Nëse doni me dhonë një përgjigje, foltorja është për ju. Kryetari ka me e dhonë një përgjigje.

Bexhet Xheladini: Kryesues, nuk është mirë, ti sidomos, me bo propagandë dhe shpifje. Dëgjo, njëlloj është sikurse me e shpallë tenderin publik me e bo pastrimin e rrugëve lokale nga bora. Edhe ti kompanisë ke me ia dhënë paret. Kur ta shpallish tenderin, ti s'ke nevojë mo me ia pague naftën. Këtu është fjala për rekrutimin e stafit, i cili e ka bo mirëmbajtjen edhe të rrugëve nga bora, por edhe e ka bo mirëmbajtjen e natyrës. Në këtë kontratë është edhe çështja e mjekëve në QKMF që punojnë, e njëjta kontratë është. Ky Vendimi që e ke parë ti, që e ke marrë, është që vetëm këta persona janë të autorizuar me shkue me marrë naftë në emër të Komunës për pastrimin e borës. Do të thotë, shpenzimet e naftës nuk i barten kompania, por Komuna. Thirrja publike me OJQ-në është bërë vetëm për pagesën e stafit. Unë nuk e di ku e ke lexue që paska të kaluar kriminale ajo OJQ, por për këtë mundish edhe me dhënë përgjegjësi. Nëse ata të Human Care e dëgjojnë këtë deklaratën tënde, ata mundin me të padit lirisht. Jo, për ty unë po e shoh që nuk është problem, se edhe qata emrat që i qite këtu nuk është e lejume. Na vendimet i publikojmë. E ke marrë, po ti ke mujt me mbajt për vete, këta secili kanë mujt me hy me i pa. E ke këshilltarin pranë, konsultohu.

Uran Halimi: Falemnderit, kryetar! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën, për çështje ndryshe prej

kësaj? Jo për shofera, jo për pastrues të rrugës. Një minutë replikë e ka Dritoni, meqenëse bash iu drejtue drejtori me tamam. Unë jam Urani, unë jam delegat, nëse mu më padit unë jam delegat. Falemnderit shumë, po unë mbaj përgjegjësi, tash pse më ke votue ti, unë s'bon edhe bukë mos me hongër. Jo more se s'është, unë personalisht po e mbaj përgjegjësinë, s'po e marr si institucion.

Driton Ademi: Falemnderit, kryesues! Unë nuk e di çka ka drejtori me mu personale, po kjo është hera e tretë që po del në foltore edhe po ma përmend emrin që kam konë pjesë e Kabinetit të kryetarit. Po mirë, nëse ke pa diçka jashtëligjshëm edhe jashtë kontratës, del edhe demanto ose çojë edhe në gjykatë. S'ke nevojë, qe hera e tretë që më tha. Jem konë, po jem konë, publikisht e pranoj se jam me dokument zyrtar. E po pse po ma përmendish? Jo, nuk po më vjen inati, arsyeja është pse po e përmendish kur unë vetë e pranoj. E ti nuk po e pranosh qet listë këtu. S'mundish me ia dhonë një OJQ-së ti edhe me ia pague naftën. Nënshkrimi është i kryetarit. Domethënë unë po ta jap ty, me ta pague edhe naftën. Jo more jo, se ti i ke fitue 200 mijë euro, ti duhet me i mbulue shpenzimet edhe të naftës, edhe të pagave. A qetash edhe bukën me ta mbulue, edhe udhëtimin me ta mbulue. Kjo nuk po vjen me u përputh më këtë, unë nuk po e kuptoj. Edhe çështjen e pagës, unë të thashë, jam konë zyrtar publik, e pranoj, se jam konë me dokumenta të rregullta, edhe nëse ka diçka që ke pa jashtëligjshëm, e ke gjykatën, urdhëro, mundish me folë ku të duash. Kërkuj nuk i tutem unë, i lirë jam. Falemnderit!

Uran Halimi: Shumë falemnderit, Driton! Një minutë, drejtor. Shkurt!

Vetim Ramadani: Driton, asgjë personale nuk kam me ty. Ti e dish shumë mirë, ne qëndrojmë jashtëzakonisht mirë si shokë jashtë seancës, por kjo s'do të thotë që nuk duhet me u ballafaque edhe me pas bindje të ndryshme për një çështje të caktuar. Thaje ku të duash fol, fola. Thaje çka ke problem. Problem s'kam me ty që të ka emërue Shaban Shabani – shumë normale, është Kabineti vet – unë e kam pas problemin pse s'ke ardhë në punë, o burrë. S'je konë asnjë ditë në punë, është ID Kartela. Ti nuk ke ardhë në punë, qaty i konë probemi im, asnjë problem tjetër personal me ty s'e kam. Sa për listën, asnjë problem s'e kam, se ajo lista është njëjtë, marrëveshje është bo, ka pas thirrje publike, ka pas afate ligjore, janë respektue të gjitha, ka pas komision që është përzgjedhë fituesi. Është njëjtë, sikur me shkue në laborator edhe shkon Auto MED i servison. Po Auto MED që servison nuk i merr mostrat prej Prishtinës me ardhë me i provue aparatat. Harxhi është i joni, traktorat janë konë tonit, kryetari ka bo Vendim me u shfrytëzue nafta për traktorët tonë. Thjesht, na procedurën e rekrutimit të punëtorëve nuk kemi mund me e bo. Në momentin që na ka ardhë rekomandimi prej Auditorit që nuk guxoni me bo kontrata mbi vepër, na jemi tërheq prej asaj pune, se jemi frigue. Ligjit është normale me iu frigue në demokraci. Jemi frigue me e bo qato, kemi shkue në format tjetër, kemi hap thirrje publike për rekrutim, jo për diçka tjetër. Falemnderit!

Samidin Xheladini: Prej fillimit. Kanë qenë Komuna në Vlorë, 4 netë e 5 ditë, punëtorët e Komunës, edhe una jam lajmëruar me kohë, një javë ditë përpara, edhe e kam lënë edhe një shok rezervë aty e kam lënë vendin. I kam thënë Suadit, nënkryetarit Resulit, Ademit, edhe stafit disa tjerëve, në mënyrë që mos me m'anashkaluar, me thonë jo unë, jo ai e jo ky. Nejse, kur ka ardhë puna kanë shkue këta. Kur janë kthyer, Ademin e kam pyetur, edhe para se me shkue ka thonë s'ke të drejtë. Pse mu s'më keni marrë? "Se ju punëtorët e Komunës jeni konë në Turqi". Ky s'u konë në Turqi. Ademi s'u konë në Turqi, na jemi konë. Ai ka thonë, na jemi konë e ai s'u konë. Ama ai ka thonë, nuk thashë unë. E dyta, tash e kam edhe një shqetësim tjetër, unë atij të OSBE-së i kam thënë, mos me mbajt takime diskriminuuese. OSBE-ja edhe disa shoqata po mbajnë takime diskriminuuese. Hera e fundit le të jetë – unë dje e kam njoftuar edhe zyrtarin tonë edhe atë italianin – s'ka takime diskriminuuese. Gratë, femrat, deputetet, gratë deputete, gratë asambleiste, veç me to mbajnë takime. Na çka jemi? Krejt kemi të drejta të barabarta. Edhe ma e keqja, që po due me e thonë, po çohen po organizojnë, në të njëjtën kohë takimi me gra atje. S'ka takime kur ta mbahet Kuvendi. Merrni ka 550 euro, le ta di opinionin, na hiç s'marrim, asnjë cent. Unë, Naseri e plotë do, zero-zero marrim edhe po rrimë, as nuk dalim përjashta. Nuk është mirë me bo këso veprime, hera e fundit le të jetë. Plus, edhe ata në Komitet 700 euro i marrin. E na i marrim zero-zero, edhe me i thonë dikuj që i marrim zero edhe rrimë këtu e kryjmë punë, se jemi të zgjedhur, me paga e pa paga. Qeshtu, edhe ma jepni përgjigjen, due përgjigje kush ka vendos që unë mos me qenë aty. Jo, po është shumë fyese, se na s'kemi të drejtë kuvendarët, e këta kanë të drejtë. Na delegatë jemi e i kemi marrë, këta s'po na marrin neve. Qetu është problemi.

Uran Halimi: Falemnderit! A ka dikush vullnetin për me i dhonë përgjigje nga ekzekutivi z.Samidin Xheladini? Jo, ky s'un të jep përgjigje, s'ka të drejtë. Po më vjen keq, po ky s'ka të drejtë me e marrë fjalën, veç nëse unë ia kërkoj. Nedžmidin Sejdlar e ka kërkuar fjalën.

Nedžmidin Sejdlar: Kryesues, me të vërtetë çka njeva këtu për këtë OJQ, është shqetësuese sipas meje. Edhe ne këtu si Kuvend, duhet pa qare me e prurë në Kuvend, me kqyrë çka është puna e qasaj OJQ-së. Se unë këtu, çka kam dëgjue prej kryetarit, prej shefit të Administratës, që Komuna e jep vendimin, me traktorat e Komunës me shkue me marrë naftë për me pastruar borën në komunë. Ajo po del sikur në ëmbëltoare me shku me iu ble edhe tepsitë për me ta maru bakllavën. Na e kemi kontrakti OJQ-në me traktorat tonë, na po ia japim naftën edhe plus 186 mijë euro. Kryesues, më fal se me ty e kam, unë e kam shumë serioz, ai ishte veç një shembull. Do të thotë, na jau kemi dhënë traktorat që janë në pronësi të Komunës, na i mushim rezervuarat me naftë dhe ata na marrin neve 186 mijë euro. Për çka? Kryetari tha për mirëmbajtje të natyrës, nuk e di kryetar a jeni konë kah Gorja çfarë natyre kemi të mirëmbajtur. Ju thatë diçka me spital, është mirë kryesues, për seancën e ardhshme me e qit

në pikë të rendit të ditës, ta diskutojmë, të kqyrim çka është t'u bo kjo OJQ-ja. Falemnderit shumë!

Uran Halimi: Falemnderit shumë, z.Sejdilar! Na si Kuvend kemi të drejtë me lyp raportim prej kësaj OJQ-së edhe me hulumtue nëse ka të gjetura, nëse jo, duhet edhe me kërkue falje, me u bo të sinqertë, se mundim edhe me gabue. Po nëse ne mendojmë që ka shkelje, mundim me lyp një raport në lidhje me këtë OJQ-në, ku, qysh ka funksionue edhe cilat janë të drejtat që ia garanton ligji kësaj OJQ-së edhe këtij ekzekutivi për me ndërmarrë këso hapa të këtij lloji. Sidoqoftë, unë ju falënderoj shumë për pjesëmarrjen, për durimin! Ju falënderoj edhe për pjesëmarrjen në debate! Shihemi në seancën e radhës!

Kryesuesi i Kuvendit

Uran Halimi